



UNIVERSITETI/UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË

# VJETARI 2022

[www.umib.net](http://www.umib.net)



# Përmbajtja

---

Fjala e rektorit.....	4
Misioni dhe Vizioni.....	5
Menaxhmenti.....	6
Këshilli Drejtues.....	9
Senati.....	10
Komisioni Qëndror i Studimeve dhe Këshilli Botues.....	11
Parlamenti Studentor.....	12
Fakultetet dhe programet e studimit.....	13
Marrëveshjet e bashkëpunimit.....	20
Storie Suksese.....	24
Punimet Shkencore.....	26
Statistika e Përdorimit të Uebit për 2022.....	29
Statistikat e Rrjeteve Sociale për 2022.....	32
Lajme dhe ngjarje .....	34

# Fjala e rektorit

Të nderuar,

Universiteti “Isa Boletini”- Mitrovicë (UMIB), ka krijuar mundësi të mëdha për të rinjtë e rajonit, të cilët duke u bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë, njëkohësisht të bëhen pjesë e tregut të punës. Në UMIB janë të akredituara 20 programe, të cilat janë mjaft atraktive dhe të kërkuara jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit. Si të tilla ato paraqesin një derë të hapur për ata që duan të ecin në hap me të rejtat në shkencë dhe gjithashtu në tregun global të punës.

Përveç programeve, kabineteve, laboratorëve që ofrohen në UMIB, një segment tepër të rëndësishëm paraqet bashkëpunimi me kompanitë publike dhe ato private në vend. Si rrjedhojë studentët tanë mund të kryejnë praktikën në kompanitë që ndërlidhen me natyrën e studimeve, duke e zënë shpejtë hapin e teknologjisë së re. Në kuadër të Universitetit tonë, tashmë janë krijuar edhe mekanizma të tjerë në shërbim të studentëve, të cilët poashtu ndikojnë në rritjen e cilësisë së punës dhe përgatitjes së kuadrove të reja. Qendra e Inovacionit, asociacioni “Alumni”, Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Bordi Këshillëdhënës që përbëhet prej njerëzve të biznesit dhe universitetit, shpërfaqin një qasje të re për universitetin dhe për studentët. Konferencat shkencore që tashmë po bëhen tradicionale, kanë krijuar një imazh të një institucioni të mirëfilltë shkencor. Ju faleminderit!



Prof. dr. Alush Musaj

## MISIONI

Misioni i UMIB-it është që të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kuadrove në fusha unike për Kosovën, rajonin e më gjerë, i dedikuar të zhvillojë kërkime shkencore, projekte profesionale, këshillime profesionale duke qenë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes të mirëqenies dhe avancimit shoqëror.

## VIZIONI

Vizioni i UMIB-it është të jetë Institucion i Arsimit të Lartë lider në rajon, në edukim dhe hulumtim shkencor, për përgatitjen e kuadrove konkurrentë në fusha unike për Kosovën dhe rajonin, për të përmbushur kërkesat e së tashmes dhe projektuar nevojat e së ardhmes, për nevojat shkencore – akademike, të ekonomisë së tregut, institucioneve e diplomacisë, i fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e UMIB-it, janë:

- Përgjegjësi dhe Respektim i ndërsjellë;
- Drejtësi dhe Ndershmëri;
- Integritet dhe Llogaridhënie;
- Diversitet dhe mirëqenie;
- Kreativitet dhe Liri Intelektuale;
- Kujdesi ndaj mjedisit dhe shoqërisë.

## MENAXHMENTI




**REKTOR  
PROF. DR. ALUSH MUSAJ**



**Prorektore për  
Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe  
Zhvillim të Cilësisë  
Prof. asoc. dr. Merita Shala**



**Prorektor për Bashkëpunim  
Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore  
Prof. dr. Behxhet Shala**



**Prorektore për  
Buxhet dhe Financa  
Prof. asoc. dr. Ajtene Avdullahi**



Sekretar i përgjithshëm

**AVDYL BEQIRI**



## KËSHILLI DREJTUES

Prof. ass. dr. Ilir Mazreku- kryesues

Prof. asoc. dr. Gazmend Kaçaniku- zëvendës kryesues

Prof. asoc. dr.techn. Salem Lepaja – anëtar

Prof. asoc. dr. Valdet Gjinovci- anëtar

Prof. asoc. dr. Halil Bajrami-anëtar

Prof. asoc. dr. Bashkim Bellaqa-anëtar

Ass. Fatbardha Hoxha-anëtar



# SENATI

Prof.dr Alush Musaj-ректор	KRYESUES I SENATIT
Prof.asoc.dr Merita Shala-prorektore	PROREKTORE/ PROF.ASOC NE FAKULTETIN E EDUKIMIT
Prof.dr Behxhet Shala-proректор	PROREKTOR/ PROF.DR NE FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE
Prof.asoc.dr Ajtene Avdullahi-prorektore	PROREKTORE/ PROF.ASOC NE FAKULTETIN EKONOMIK
Prof.dr Naser Peci-FGJ	DEKAN NE FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE
Prof.dr Gani Maliqi-FGJ	PROF.DR NE FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE
Prof.asoc.dr Milaim Sadiku-FTU	DEKAN NE FAKULTETIN E TEKNOLOGJISE USHQIMORE
Prof.dr Aziz Behrami-FTU	PROF.DR NE FAKULTETIN E TEKNOLOGJISE USHQIMORE
Prof.asoc.dr Faton Merovci-FIMK	DEKAN NE FAKULTETIN E INXHINIERISE MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE
Prof.ass.dr Fitim Zeqiri-FIMK	PROF. ASISTENT NE FIMK
Prof.asoc.dr Besim Gollopeni-Fedu	DEKAN NE FAKULTETIN E EDUKIMIT
Ass. Ylli Hashani-Fedu	ASS NE FAKULTETIN E EDUKIMIT
Prof.asoc.dr Islam Qerimi-FJ	DEKAN NE FAKULTETIN JURIDIK
Prof.ass.dr Mimoza Aliu-FJ	PROF. ASISTENTE NE FAKULTETIN JURIDIK
Prof.asoc.dr Qazim Tmava-FE	DEKAN NE FAKULTETIN EKONOMIK
Ass. Milaim Mehmeti-FE	ASISTENT NE FAKULTETIN EKONOMIK
Lulzim Bunjaku	UDHEHEQES I SEKTORIT PER TI
Ariona Rushiti- PS (ex-officio)	KRYESUESE E PARLAMENTIT STUDENTOR
Festim Murati	STUDENT
Avdyl Beqiri (ex-officio)	U.D SEKRETAR I PERGJITHSHEM I UIBM-se

## ANËTARËT E KOMISIONIT QENDROR TË STUDIMEVE

Merita Shala, prorektore-kryetare e Komisionit

Ismet Mulliqi, profesor- anëtar

Sabri Avdullahi, profesor-anëtar

Avdi Salihu, profesor-anëtar

Arta Dauti, profesoreshë -anëtare

Besart Hajrizi, asistent -anëtar

Albana Sadiku, asistente- anëtare

Bleona Halili, studente-anëtare

Arbër Zeqiri, studente-anëtare

## ANËTARËT E KËSHILLIT BOTUES

Prof. dr. Behxhet Shala, prorektor,

Prof. ass. dr. Kemajl Zeqiri, anëtar FGJ,

Prof. ass. dr. Mehush Aliu, anëtar FTU,

Prof. ass. dr. Islam Qerimi, anëtar FJ,

Prof. ass. dr. Saranda Kika-Bahtiri, anëtar Fakulteti i Edukimit

Prof. ass. dr. Qazim Tmava, anëtar Fakulteti Ekonomik

# PARLAMENTI STUDENTOR

## Përbërja e Parlamentit Studentor

Ariona Rushiti (Kryetare)  
Festim Murati (Senator Student)  
Ardian Berisha (Nënkryetar)  
Plotmira Haziraj (Sekretare)  
Fortesa Jeliqi (Sekretar organizativ)  
Fatime Hasani  
Arber Zeqiri  
Mentor Peci  
Donjeta Jashari  
Donika Pllana  
Omer Maksuti  
Ylltare Ferati



# FAKULTETET DHE PROGRAMET E STUDIMIT

---



# FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

**BACHELOR**

**XEHTARI**

**GJELOGJI**

**MAERIALE & METALURGI**

**MASTER**

**XEHTARI**

**HIDROGJELOGJI ME GJELOGJI  
INXHINIERIKE**

**MAERIALE & METALURGI**

**VENDBURIMET E LËNDËVE TË PARA MINERALE**

# FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE

---

**BACHELOR**

**INXHINIERI DHE  
TEKNOLOGJI  
USHQIMORE**

**MASTER**

**TEKNOLOGJI**

# **FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

---

**BACHELOR**

**SHKENCA KOPJUTERIKE DHE INXHINIERI**

**INXHINIERI EKONOMIKE**

**MAKINERI PRODHUESE**





**FAKULTETI JURIDIK**

**BACHELOR**

**JURIDIK**

# FAKULTETI EKONOMIK

## BACHELOR

**BIZNES DHE MENAXHMENT ME SPECIALIZIMET:**

- 1. BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET;**
- 2. MENAXHMENT DHE NDËRMARRËSI**



**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**BACHELOR**

**EDUKIM FILLOR**

# MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT

---



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHOQATËN KOSOVARE TË SHURDHËRVE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME OJQ “PREMISA”

MARRËVESHJE PËR SHKËMBIMIN E MËSIMDHËNËSVE DHE STUDENTËVE ME “LEOBEN UNIVERSITY” NË AUSTRI

MARRËVESHJE NDËR-INSTITUCIONALE ME UNIVERSITETIN TEKNIK TË RIGAS, PËR SHKËMBIM TË STAFIT AKADEMIK DHE STUDENTËVE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” NË VLORË

MARRËVESHJE PARTNERITETI ME “MONTANUNIVERSITAT LEOBEN” NË AUSTRI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË NIVEL REKTORËSH ME UNIVERSITY OF AGRIBUSINESS AND RURAL DEVELOPMENT NË PLOVDIV, BULLGARI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME TEKIRDAG NAMIK KEMAL UNIVERSITY NGA TURQIA

UIBM DHE FAKULTETIT EKONOMIK DHE TË SHKENCAVE ADMINISTRATIVE – TEKIRDAG, NAMIK KEMAL UNIVERSITY NGA TURQIA

FAKULTETI I EDUKIMIT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME KOPSHTIN DHE  
ÇEDHEN “NINA”

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE-UIBM DHE IMK  
BALLKAN PROJECT SH.P.K, PRISHTINË

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT MES FAKULTETIT JURIDIK UIBM DHE “HALIMI  
FOUNDATION INSTITUTE”

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET FAKULTETIT EKONOMIK – UIBM DHE  
FAKULTETIT EKONOMIK – PRILEP TË UNIVERSITETIT “SAINT KLIMENT OHRIDSKI” BITOLA  
NGA MAQEDONIA E VERIUT

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHËRBIMIT GJEOLOGJIK TË KOSOVËS DHE  
FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE UIBM

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ” TË GJIROKASTRËS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN E PAVARUR PËR MINIERA DHE  
MINERALE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E SAPINENZËS NË ROMË

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET FTU-SË DHE KOMPANISË “KONDITORIA”  
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MESME TË LARTË TEKNIKE “ARKITEKT  
SINANI”



# STORIE SUKSESI

---





## **ALLMIR KRASNIQI**

USHTRON FUNKSIONIN E UDHËHEQËSIT TË  
SHITJES NË VIPRINT.

## **GENTIANA BERISHA**

GENTIANA ËSHTË PUNËSUAR SI  
MËSUESE E CIKLIT KLASOR

## **ALBIONA KOLSHI**

MËSIMDHËNËSE NË SHKOLLËN "MIHAL  
GRAMENO- ANEKSI II"

## **BLEONA SMAKIQI**

MENAXHERE E PROJEKTEVE NË OJQ SOCIAL  
HOUSING AND PROPERTY RIGHTS IN KOSOVO  
(SHPRK)

## **DIELLZA PRETENI**

GENTIANA ËSHTË PUNËSUAR SI MËSUESE E  
CIKLIT KLASOR

## **FLORIJANA BEKA**

FITOI ÇMIMIN E ORATORISË "BEST SPEAKER"


# PUNIME SHKENCORE

---




# PUNIMET SHKENCORE


Publications by year




Publications by Employment Status



Publications by Faculty



Authors by Faculty




## PUNIMET SHKENCORE

Year of the publication	Faculty of Economics	Faculty of Education	Faculty of Food Technology	Faculty of Geoscience	Faculty of Geosciences	Faculty of Law	Faculty of Mechanical and Computer En
2019	7	7	23		27		2
2018	5	4	22	5	9		6
2020	14	3	14	1	13		3
2022	7	7	6	6	5		3
2017		7	16		9		2
2021	10	2	11	3	8		5
2012			6	2	1		
2011			3		4		
2013			2	3	3		
2016		2			1		
2009			4	1	1		
2010			3		2		
2015		1	1	1			
2014			4				
2007			1		1		
<b>Total</b>	<b>43</b>	<b>33</b>	<b>116</b>	<b>22</b>	<b>85</b>		<b>21</b>

Total number of publications



Percentage of publications by Faculties



Faculty

- Faculty of Food Technology
- Faculty of Geosciences
- Faculty of Mechanical and Computer...
- Faculty of Economics
- Faculty of Education
- Faculty of Geoscience
- Faculty of Law

# STATISTIKA E PËRDORIMIT TË UEBIT




## STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË UEBIT PËR VITIN 2022

Total users  
74,097

Sessions  
41,670


Views  
406,325

### Top Acquisition




### Acquisition

### Users (vs. New Users)




### Behavior



Operating system	Sessions +	New users	Active users
iOS	69,314	40,003	40,077
Android	46,676	18,562	19,727
Windows	43,525	11,326	12,409
Macintosh	3,381	1,349	1,391
Linux	1,440	657	1,310
Chrome OS	50	37	37

1 - 10 / 10 < >




## STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË UEBIT PËR VITIN 2022

	Page title	Views ▾
1.	Universiteti "Isa Boletini"- Ballina	107,541
2.	Fakulteti i Edukimit - Universiteti "Isa Boletini"	13,419
3.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike- Universiteti i Mitrov...	11,188
4.	Fakulteti Teknologji Ushqimore- Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	9,997
5.	Home - Universiteti "Isa Boletini"	9,123
6.	Njoftime - Universiteti "Isa Boletini"	8,332

	Device category	Views ▾
1.	mobile	236,423
2.	desktop	168,858
3.	tablet	989

1 - 4 / 4 < >



	Country	Views ▾
1.	Kosovo	22,767
2.	Albania	8,952
3.	Serbia	1,507
4.	Germany	308
5.	United States	247
6.	North Maced...	231
7.	Türkiye	191
8.	Italy	106
9.	Sweden	59

1 - 63 / 63

# STATISTIKAT E RRJETEVE SOCIALE

---






## STATISTIKAT E RRJETEVE SOCIALE PËR VITIN 2022

### Reach


Facebook Page reach ⓘ

134,989 ↑ 14.9%



Instagram reach ⓘ


7,429 ↓ 46.2%



### New likes and follows


Facebook Page new likes ⓘ

917 ↓ 16.6%



New Instagram followers ⓘ

357




## STATISTIKAT E RRJETEVE SOCIALE PËR VITIN 2022

### New likes and follows


Facebook Page new likes ⓘ

917 ↓ 16.6%



New Instagram followers ⓘ

357 –



# LAJME DHE NGJARJE

---



# STAFI AKADEMIK I FAKULTETIT EKONOMIK LIGJËROJNË NË FAKULTETIN EKONOMIK TË WEST POMERANIAN UNIVERSITY OF TECHNOLOGY NË SZCZECIN TË POLONISË

11/01/2022

Dy profesoreshat e Fakultetit Ekonomik të Universitetit Isa Boletini në Mitrovicë Ajtene Avdullahi dhe Filloreta Kunoviku Demiri sot mbajtën ligjeratën e parë në kuadër të mobilitetit të stafit akademik në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Teknologjisë të West Pomeranian, në Szczecin të Polonisë. Përndryshe, gjatë kësaj jave, si vazhdimësi e marrëshjes së mobilitetit të stafit dhe studentëve të Fakultetit Ekonomik, ato do të vazhdojnë ligjerimin dhe aktivitetet tjera me studentët e mobilitetit që vijnë nga vende të ndryshme në kuadër të Erasmus+.



# QATEK – ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT AKADEMIK NË KËRKIMIN SHKENCOR NË PËRGATITJE E MËSIMDHËNËSVE

19/01/2022

Në kuadër të projektit QATEK, në datat 17-18 janar u organizua sesioni i dytë i programit të ngritjes së kapaciteteve në modulën kërkimor në përgatitjen e mësimitdhënësve me temën “Menaxhimi i të dhënave dhe analiza statistikore duke përdorur SPSS”.

Prof. Merita Shala, koordinatore e projektit QATEK për UIBM, theksoi se programi i zhvillimit profesional të stafit akademik të Fakultetit të Edukimit, për shfrytëzimin e analizave statistikore duke përdorur SPSS, rrit mundësitë që të përmirësohet drejtpërdrejt cilësia e përgatitjes së mësimitdhënësve të rinj, dhe në të njëjtën kohë rrit përfshirjen e shfrytëzimit të evidencave nga punimet shkencore në përmbajtjet e programit që përgatit mësimitdhënësit e rinj.

Punëtorja u drejtua nga profesorët e Universitetit të Lubjanës, partnerë në projektin QATEK.



# NË UIBM DO TË MBAHET “KONGRESI BALLKANIK I PASURIMIT TË MINERALEVE”

19/01/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), kanë nisur përgatitjet për organizimin e “Kongresit Ballkanik të Pasurimit të Mineraleve”, që planifikohet të mbahet më 28, 29, 30 dhe 31 maj 2023. Ky Kongres që do të mbahet në UIBM, organizohet nga “Balkan Academy of Science on Minerals” (BASM).

Për organizimin e këtij Kongresi, që paraqet një ngjarje të shënuar jo vetëm për UIBM, por shumë më gjerë, u bisedua të mërkurën nga rektori, prof. dr. Alush Musaj dhe profesori universitar, Shyqri Kelmendi, ekspert i njohur për miniera dhe minerale. Në takim u bisedua për obligimet e UIBM sa i përket organizimit të kësaj konference shkencore.



## NË UIBM DO TË MBAHET “KONGRESI BALLKANIK I PASURIMIT TË MINERALEVE”

25/01/2022

Në kuadër të bashkëpunimit dhe marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës, Prorektorja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë Prof. Merita Shala dhe Prorektori për Bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore Prof. Behxhet Shala, u takuan sot me përfaqësues të Institutit Pedagogjik të Kosovës, hulumtuesit Luljeta Shala dhe Selim Mehmeti.

Takimi u fokusua në mundësitë e organizimit të përbashkët të konferencës vjetore me temë bosht në fushën e arsimit.



# UIBM RENDITET I DYTI NË KOSOVË NGA WEBOMETRICS SIPAS CITIMEVE NË GOOGLE SCHOLAR

28/01/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është renditur i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë, sa i përket kriterit të citimeve në profilet e Google Scholar në ranglistën e webometrics të shpallur në janar 2022. Në këtë rangim, UIBM ka dalur i dyti pas Universitetit të Prishtinës, me 1044 citime.

Rangimi është bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë periudhës 10-20 janar 2022, dhe në versionin e publikuar në webometrics, radhiten vetëm universitetet me mbi 1000 citime. Në mesin e 4800 universiteteve botërore, UP-ja dhe UIBM- i janë të vetmet universitete publike në Kosovë që ndodhen në versionin aktual të publikuar.






# UIBM RENDITET I DYTI NGA WEBOMETRICS NË MESIN E UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË KOSOVË

01/02/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është renditur i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë në ranglistën e publikuar nga webometrics në janar 2022. Në mesin e 31 mijë universiteteve nga e gjithë bota, UIBM në ranglistë është renditur në vendin e 12 909, duke shënuar ngritje për 38 vende në krahasim me vitin e kaluar.

Ka disa vite që UIBM vazhdon të ngritet në këtë ranglistë ndërkombëtare që freskohet dy herë në vit. Sipas sqarimeve nga webometrics, indikatorë matës për rangimin e universiteteve merren: Visibiliteti i webit, transparenca ( studiuesit më të cituar) dhe ekselencia (punimet më të cituara).



# DREJTUESIT E UIBM DHE HERAS+ DAKORDOHEN PËR TEMAT E ARDHSHME TË BASHKËPUNIMIT

10/02/2022

Drejtuesit e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) dhe ata të Heras+, në një takim të përbashkët të zhvilluar të enjten në UIBM, janë dakorduar për temat e ardhshme të bashkëpunimit. Në këtë kontekst, u përmend mbështetja për hartimin dhe rishikimin e rregulloreve të nevojshme, standardin e laboratorëve dhe rishikimin e Planit strategjik të UIBM. Rektori prof.dr. Alush Musaj, falënderoi drejtuesit e Heras+ për mbështetjen e vazhdueshme që kanë ofruar për UIBM. “Jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin dhe mbështetjen që keni ofruar për UIBM. Jemi dëshmitar të rezultateve të prekshme dhe inkurajuese, prandaj jemi shumë mirënjohës”, theksoi ai.



# UIBM TASH E TUTJE MË TË DREJTË VOTE KËSHILLUESE NË AGJENCINË UNIVERSITARE FRANKOFONE

11/02/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) ka kaluar nga anëtar vëzhgues në anëtar të asocuar në Agjencinë Universitare Frankofone (AUF). Si rrjedhojë tash e tutje UIBM ka të drejtë për votë këshilluese në Ansamblenë e Përgjithshme të AUF. Në njoftimin e AUF për këtë avancim të statusit të UIBM në këtë organizatë, gjithashtu shprehet besimi për forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm. Po ashtu drejtuesit e AUF falënderojnë ata të UIBM për besimin e treguar sa i përket bashkëpunimit.



# PROJEKT PËR STANDARDIZIMIN E “SHTOJCËS SË DIPLOMËS” NË UNIVERSITETET PUBLIKE

16/02/2022

Me mbështetjen e “Alled 2” (Harmonizimi i Arsimit dhe i Aftësisimit me Nevojat e Tregut të Punës) ka nisur realizimi i një projekti të përbashkët nga universitetet publike në Kosovë për standardizimin e “Shtojcës së diplomës”. Një gjë e tillë tashmë është e rregulluar edhe me norma ligjore, ndërkohë që vlerësohet edhe si kriter në procesin e akreditimit të universiteteve.

Për të diskutuar për detajet e këtij projekti, rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj së bashku me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim Koordinatorin për Cilësi dhe Arsim të Lartë në “Alled 2”, Anton Gojanin si dhe ekspertin e angazhuar, prof.dr. Ferdije Zhushi.



## PROREKTORJA PROF.ASS.DR. MERITA SHALA, PËRFAQËSON FAKULTETIN E EDUKIMIT TË UIBM NË KOMITETIN KËSHILLDHËNËS PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME-MASHTI

*18/02/2022*

Më 16 shkurt me organizim të MASHTI, u mbajt takimi i parë i Komitetit Këshilldhënës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili është një trup këshilldhënës i MASHTI-t.

KKEFH është krijuar me vendim të Ministres Arbërie Nagavci për të ofruar një forum gjithëpërfshirës dhe multisektorial të Edukimit dhe Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme. Ky komitet përbëhet nga anëtarë të deleguar nga Fakultetet e Edukimit të Universiteteve të ndryshme publike, nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e edukimit, mbrojtjes së fëmijëve, shëndetësisë dhe mirëqenies. KKEFH kryesohet nga zëvendësministrija e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku Bërdyna. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi dhe koordinimi i angazhimeve të institucioneve e organizatave kyçe që punojnë në këtë nivel edukimi.



# UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI” ORGANIZON KONFERENCËN ME TITULL “PUNËTORIA E DYTË NDËRKOMBËTARE” (2ND INTERNATIONAL WORKSHOP), NË KUADËR TË PROJEKTIT “DUALAFS”

18/02/2022

Projekti “DualAFS” synon zhvillimin e njohurive të studentëve dhe punësimin e të diplomuarve , po ashtu përmirësimin e konkurrencës në shkencat e bujqësisë dhe blegtorisë, përpunimit të ushqimit dhe përmirësimin e konkurrencës së bizneseve dhe përfituesve të tjerë në bujqësi e blegtori dhe cilësinë e sigurinë e produkteve ushqimore me prejardhje shtazore.

Partnerët tanë në këtë projekt janë: Universiteti “Nuertingen-Geiingen” nga Gjermania, i cili është partner udhëheqës, Universiteti “Savonia” nga Finlanda, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, nga Shqipëria, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Në kuadër të kësaj punëtorie do të mbahet edhe një konferencë ndërkombëtare, ku do të jenë të ftuar partnerë të universiteteve nga sektori i biznesit, nga institucionet publike dhe përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, po ashtu nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



# TRE STUDENTË TË FTU-SË DO TË QËNDROJNË NJË SEMESTËR NË UNIVERSITETIN “VAN HALL LARENSTEIN”

*18/02/2022*

Në kuadër të programit Erasmus+, përkatësisht bashkëpunimit me Universitetin e Shkencave të Aplikuara “Van Hall Larenstein” në Leeuwarden të Holandës, tre studentë nga Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në Universitetin “Isa Boletini”, do qëndrojnë për një semestër në Holandë. Kursin e teknologjisë ushqimore janë duke ndjekur studentët: Shqipe Gashi dhe Albin Aliu, ndërsa kursin për trajtimin e ujërave shkarkuese, Endrit Kelmendi.







# U MBAJT KONFERENCA E REKTORËVE: “UNIVERSITETET PUBLIKE DHE PROFILIZIMI I STUDIMEVE TË LARTA”

04/03/2022

Me rastin e 9 -vjetorit të themelimit të tri universiteteve publike: Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan (UKZ) dhe Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë (UFAGJ), u mbajt të premten në UIBM Konferenca e Rektorëve “Universitetet publike dhe profilizimi i studimeve të larta”. Përveç rektorëve, prorektorëve, anëtarëve të Këshillave Drejtuese etj, të pranishëm ishin edhe zëvendësministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Dukagjin Pupovci dhe drejtori i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), Naim Gashi.

Të pranishmëve në cilësinë e nikoqirit dhe kryesuesit të Konferencës së Rektorëve, ju drejtua fillimisht rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj. Ai uroi për përvjetorin e 9 të themelimit të këtyre tri universiteteve dhe shprehu kënaqësinë për organizimin e Konferencës së Rektorëve në UIBM, si një ngjarje e shënuar.



# PËRFUNDOI PUNËTORIA E DYTË NDËRKOMBËTARE “DUAL CURRICULA – STUDY AND WORK PRACTICE IN AGRICULTURE AND FOOD SAFETY”

04/03/2022

Në ditën e tretë dhe të fundit të “2nd International Workshop” në kuadër të projektit DualAFS, që u mbajt në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, pjesëmarrësit vizituan verarinë “Stone Castle” në Rahovec. Në këtë vizitë studimore u vizituan laboratorit, procesi i filtrimit dhe linja teknologjike e mbushjes dhe paketimit të verës. Për historikun, procesin e prodhimit, eksportin dhe investimet që janë bërë në kompani, pjesëmarrësit i njoftoi inxhinieri, Fejzullah Berisha.

Një aktivitet tjetër ishte edhe punëtorja për zhvillimin dhe avancimin e kurrikulave të orientuara drejt praktikës në universitetet partnerë nga Shqipëria dhe Kosova. Kurrikula duale janë hartuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin “Fan Noli” Korçë, ndërsa Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” kanë avansuar pjesën praktike të kurrikulave aktuale.



# STUDENTËT NDAJNË PËRVOJAT ME KOLEGËT PËR MOBILITETIN E TYRE

07/03/2022

Me rastin e shënimit të 9 – vjetorit të themelimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), Parlamenti Studentor ka organizuar një takim me studentë për të ndarë përvojat e atyre që kanë qenë pjesë e mobilitetit në vende të ndryshme. Përveç studentëve, të pranishëm ishin edhe menaxhmenti i UMIB dhe dekanë të njësive akademike.

Rektori, prof.dr. Alush Musaj, i cili shoqërohej nga prorektorët, falënderoi Parlamentin Studentor për këtë organizim. Ai inkurajoi studentët që të shfrytëzojnë sa më shumë mundësitë që ofrohen për mobilitet në universitete të ndryshme.



## KONFERENCA E KATËRT NDËRKOMBËTARE MULTIDICIPLINARE PËR GJEOSHKENCË (IMGC2022) DO TË MBAHET MË 13 DHE 14 TETOR 2022

07/03/2022

Këshilli Organizativ për Konferencën Ndërkombëtare Multidisciplinare për Gjeoshkencë (IMGC2022) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2022 në UIBM, vendosi që edicioni i katërt i kësaj konference të mbahet më 13 dh 14 tetor 2022. Këshilli Organizativ, përveç përfaqësuesve nga Fakulteti i Gjeoshkencave në UIBM, ku kryesues është profesori Sabri Avdullahi, ka në përbërje: Gani Kastratin e Gani Maliqin nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Luan Morinën nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Skender Sallahun nga Departamenti i Minerave në Ministrinë Ekonomisë.

Të pranishëm në mbledhjen e parë të KO ishin edhe rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj dhe prorektorët. Musaj vlerësoi punën e mirë që është bërë në kuadër të kësaj konference në tri edicionet e mëparshme dhe shprehu besimin për suksesin e saj edhe në edicionin e katërt.



## U MBAJT SESIONI INFORMUES PËR TRAJNIMET IT ESSENTIALS DHE SOFT SKILLS

17/03/2022

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e trajnimeve IT Essentials dhe Soft Skills, Prishtina REA në bashkëpunim me Qendrën për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, kanë mbajtur të enjten një sesion informues me studentët e UIBM. Gjatë sesionit janë dhënë informata të detajuara për organizimin, aplikimin dhe përmbajtjen e trajnimeve.

Trajnimet do të mbahen me prezencë fizike, janë falas dhe do të zgjasin 5 muaj. Afati i fundit për aplikim është data 25.03.2022. Këto trajnime në kuadër të Programit Youth Online and Upward (YOU) – KODE Project, implementohen nga Ministria e Ekonomisë dhe mbështeten nga Banka Botërore.



# PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT AKADEMIK NË KËRKIMIN SHKENCOR

18/03/2022

Në datat 16-17 mars, projekti QATEK organizoi sesionin e tretë të programit për ngritjen e kapaciteteve në modulën kërkimorë në përgatitjen e stafi akademik me temën “Testet statistikore dhe asociacionet statistikore duke përdorur SPSS”.

Objektivi kryesor i punëtorisë ishte përfshirja e pjesëmarrësve në angazhimin praktik me analizën e të dhënave përmes SPSS. Seminari mbuloi tema se si të llogariten statistikat përshkruese (dhe çfarë kuptimi kanë ato) si dhe teste statistikore bazë si T-test, ANOVA, test joparametrik, korrelacion dhe chi-square. Për më tepër, pjesëmarrësit mësuan se si të zgjidhnin një test të përshtatshëm statistikor dhe të merrnin udhëzime se si të interpretonin dhe shkruanin rezultatet. Në këtë punëtori morën pjesë personeli akademik nga Fakulteti i Edukimit.

Punëtorija u drejtua nga profesorët e Universitetit të Lubjanës, Prof. Dr. Janez Vogrinc dhe Ass. Miha Matjašič.



# UIBM PJESË E PUNËTORISË “AVANCIMI I KULTURËS SË KËRKIMEVE NË IAL TË KOSOVËS”

28/03/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr. Behxhet Shala dhe dekani i Fakultetit të Edukimit, prof.dr. Besim Gollopeni, po marrin pjesë në punëtorinë “Avancimi i kulturës së kërkimeve në IAL të Kosovës”, që ka filluar të hënën në Universitetin e Ekonomisë Kombëtare dhe Botërore në Sofje. Pjesë e kësaj punëtorie disa ditore janë të gjitha universitetet publike të Kosovës, Universiteti i Sapienzës nga Italia etj.



# UIBM FITUES I PROJEKTIT TË HERAS PLUS NË THIRRJEN “SOCIAL DIMENSION SMALL GRANT”

29/03/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë ka arritur të fitoj një projekt lidhur me thirrjen e HERAS Plus për Social Dimension Small Grant. Projekti synon që të ofroj universitetin sa më afër shërbimit në komunitet, përmes edukimit ligjor për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Shërbimi në komunitet mbetet njëra ndër komponentet kryesore të UIBM-së, dhe këtë e ka dëshmuar me një seri aktivitete, e ndër to edhe ky projekt.

I tërë projekti do të implementohet nga ana e grupit punues të projektit, që të gjithë anëtarë të stafit akademik dhe studentë të UIBM-së“.





## REKTORI MUSAJ PO MERR PJESË NË PUNËTORINË PËR “NDËRTIMIN E BASHKËPUNIMIT RAJONAL NË ARSIMIN E LARTË”, QË PO MBAHET NË SOFJE

29/03/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, po merr pjesë në punëtorinë për “Ndërtimin e bashkëpunimit rajonal në arsimin e lartë”, që po mbahet në Universitetin Teknik të Sofjes, në kuadër të projektit QUADIC. Pjesë e kësaj punëtorie janë universitetet publike të Kosovës, Universiteti Teknik i Sofjes. Universiteti i Sapienzës etj.

Gjatë tri ditëve sa do të zgjas kjo punëtori, do të prezantohet një draft për një Marrëveshje Mirëkuptimi sa i përket krijimit të një rrjeti rajonal të bashkëpunimit, mandej do të realizohen vizita në hapësirat universitare si dhe do të diskutohet për një platformë të përbashkët softverike.

Rektori Musaj, theksoi se në kuadër të këtij projekti po ofrohen mundësi për shkëmbime përvojash dhe rritjen e bashkëpunimit universitar në rajon.




# U MBAJT WEBINAR ME TEMËN “VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS NGA SEKTORI I MINIERAVE NË KANADA”

29/03/2022

Në kuadër të bashkëpunimit të Fakultetit të Gjeoshkencave, përkatësisht Departamentit të Xehetarisë me Universitetin Calgary – Kanada dhe ambasadën Kanadeze, u mbajt Webinar lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjeds të aktiviteteve minerare.

Vec, profesorëve dhe studentëve të FGJ-së, në këtë takim morrën pjesë edhe perfaqësues tjerë nga institucionet minerare: Ministria e Ekonomisë, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Shërbimi Gjeologjik, Trepca, KEK si dhe perfaqësues të kompanive private minerare.

Ky takim u moderua nga znj. Syntia Dodig (Komisionere për Tregti, Ambasada Kanadeze në Kroaci dhe Kosovë), e cila potencoi rëndësinë e këtij takimi dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për zhvillimin e sektorit minerar në Kosovë. Kurse, prof. Kemajl Zeqiri (FGJ), gjatë fjalës së tij, theksoi rëndësinë që ka shkëmbimi i përvojave në mes të Universitetit Calgary dhe Fakultetit të Gjeoshkencave, jo vetëm në aspektin akademik por edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë minerare.



## REKTORI MUSAJ TAKOI AMBASADORIN E KOSOVËS NË BULLGARI

31/03/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, gjatë qëndrimit në Sofje ku po mbahen dy punëtori për arsimin e lartë: “Ndërtimi i bashkëpunimit rajonal në arsimin e lartë” dhe “Avancimi i kulturës së kërkimeve në IAL të Kosovës”, bashkë me drejtues të tjerë të universiteteve publike, ka takuar ambasadorin e Kosovës në Bullgari, Delfin Pllana. Në takim u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit me universitetet bullgare.

Në këtë kontekst, rektorët kanë marrë mbështetjen e ambasadorit Pllana, i cili u shpreh i gatshëm për të ndihmuar universitetet kosovare për rritjen e bashkëpunimit me universitetet në Bullgari. U potencua shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet universiteteve.

Ndryshe të enjten kanë përfunduar dy punëtoritë për arsimin e lartë, ku përveç universiteteve dhe kolegjeve kosovare, pjesëmarrës ishin edhe Universiteti Teknik i Sofjes dhe Universiteti i Sapienzës më Itali.



## REKTORI MUSAJ MORI PJESE NË DËGJIMIN PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM

06/04/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, ka marrë pjesë të mërkurën në dëgjimin publik për Projektligjin nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Ky dëgjim publik u organizua nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport dhe HERAS Plus.

Panelistë në këtë aktivitet ishin: Ardian Gola, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Arbërie Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Aqim Emurli nga HERAS Plus. Dëgjimi publik u organizua për të ofruar mundësi që përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, përfaqësuesit nga bota akademike, ekspertët dhe grupet e interesit të ofrojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre për Projektligjin nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.



ZHVILLOHET PUNËTORIA E RADHËS NGA PROJEKTI QATEK- UDHËHEQJA E MËSUESIT, ROLI I MËSUESIT NË PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS DHE PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE DHE TË MËSUARIT EFEKTIV

12/04/2022

Profesorët dhe asistentët e Fakultetit të Edukimit, në kuadër të aktiviteteve të parapara me projektin: Drejt një edukimi fillestar të mësimdhënësve të orientuar drejt cilësisë për ngritjen e profesionalizmit të mësimdhënësve në Kosovë (QATEK), më 6-8 prill 2022 morën pjesë në punëtori për modulet: Mësuesi drejtues dhe roli i tij/saj në përmirësimin e shkollës dhe Mbështetja e zhvillimit të nxënësve dhe të nxënit efektiv.

Qëllimi i modulit -Mësuesi kryesor dhe roli i tij/saj në përmirësimin e shkollës është të forcojë të kuptuarit e mësuesve për konceptin e udhëheqjes së mësuesve dhe implikimet praktike në lidhje me rolin proaktiv të mësuesve në përmirësimin e shkollës dhe mbështetjen e zhvillimit profesional të kolegëve.



## ËSHTË MBAJTUR “TRAJNIMI PËR SHKRIMIN E PUNIMEVE/ARTIKUJVE SHKENCORË”

14/04/2022

Më 11 – 13 Prill 2022, u organizua “Trajnimi për shkrimin e punimeve/artikujve shkencorë”, në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve kërkimore në Arsimin e Lartë në Kosovë (ResearchCult)”, ERASMUS +. Në këtë trajnim morën pjesë rreth 100 staf akademik nga universitetet publike në vend dhe nga Kolegji I-BCM. Në trajnim morën pjesë rreth dhjetë persona (stafi akademik) nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë. Trajnimi u organizua në dy grupe të ndara sipas fushave shkencore: Grupi A: Shkenca sociale dhe ekonomike, shkenca humane dhe juridike dhe Grupi B: Shkenca natyrore, inxhinieri, shkenca mjekësore, TIK dhe teknologji. Trajnuesit ishin profesorë dhe studiues nga Universiteti Sapienza në Romë nga Italia dhe Universiteti i Zagrebit nga Kroacia. Trajnimi u zhvillua në ambientet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.



# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ” TË GJIROKASTRËS 15/04/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunoj me Universitetin “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës (UGJ) me qëllim të forcimit dhe zgjerimit të shkëmbimeve reciproke në projekte kërkimore, stafit akademik dhe studentëve. Për këtë qëllim të premtën në UIBM, rektori, prof.dr. Alush Musaj dhe homologu i tij nga UGJ, prof.dr. Bektash Mema, nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në emër të këtyre dy universiteteve.

Të dy palët shprehën zotimin që do të bëjnë çdo përpjekje për të forcuar kontaktet direkte dhe bashkëpunimin kërkimor midis anëtarëve të departamenteve dhe fakulteteve të tyre përkatëse. Në këtë kuadër, universitetet do të angazhohen së bashku për të forcuar dhe zgjeruar marrëdhëniet e tyre, që kanë të bëjnë me shkëmbimet reciproke dhe bashkëpunimin në projektet kërkimore në fushat e tyre respektive.



## U MBAJT KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “ARRITJET E REJA NË SHKENCË, TEKNOLOGJI DHE ARTE”

15/04/2022

Më 14 dhe 15 prill 2022, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Arritjet e Reja në Shkencë, Teknologji dhe Arte”, i zhvilloi punimet në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Kjo konferencë organizohet në kuadër të projektit ResearchCULT, ERASMUS+, ku bashkëorganizator janë institucionet vendore të arsimit të lartë partnere në projekt, duke përfshirë Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe institucionet ndërkombëtare si: Universiteti Sapienza, Romë, Universiteti i Zagrebit, Universiteti i Ekonomisë Botërore, Sofje etj.

Në konferencë kishte folës kryesorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Konferenca u organizua në tetë sesione shkencore të ndara sipas fushave dhe morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës me prezantime nga vendi, rajoni dhe më gjerë. Nga UIBM, morën pjesë dekan i Fakultetit të Edukimit, prof. ass. dr. Besim Gollopeni i cili ishte edhe bashkëdrejtues i seksionit “Edukimi dhe trajnimi” si dhe stafi akademik me prezantime punimesh.





# AKADEMIK ILIRJAN MALOLLARI MBAJTI LIGJËRATË PËR STAFIN DHE STUDENTËT E FTU-SË

19/04/2022

Në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, për studentë dhe stafin akademik mbajti ligjëratë tematike Akademik Ilirjan Malollari nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, me titull: “Tendenca te reja në zhvillimin e shkencave të Inxhinierisë Kimike në shekullin XXI”.

Vlen të theksohet se pjesëmarrës në ligjëratë përveç menaxhmentit të FTU-së, ishte edhe Rektori i Universitetit të Gjirokastrës, “Eqrem Çabej”, Prof. Dr. Bektash Mema, Rektori i UIBM, Prof. Dr. Alush Musaj, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, Prof. Dr. Behxhet Shala dhe MSc. Jonilda Llupa, PhD kandidate nga Universiteti i Gjirokastrës.



## SESION INFORMUES PËR BURSAT E PROGRAMIT FULBRIGHT MASTER

20/04/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë u mbajt të mërkurën një sesion informues për bursat e programit Fulbright Master. Koordinatorja e programit, Nora Nimani-Musa, foli për praktikat, mundësitë dhe procedurat rreth aplikimit për studentët e interesuar të UIBM.

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr. Behxhet Shala, inkurajoi studentët që të aplikojnë në këtë program, duke pasur parasysh mundësitë e mëdha që ofron. Ai tha se do të mbështesin me informacione të nevojshme të gjithë studentët që janë të interesuar për këtë dhe mundësitë të tjera që ofrohen për ta.



## PROREKTORI SHALA MORI PJESE NË FORUMIN E PARË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË SHKENCËS

21/04/2022

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof. dr. Behxhet Shala, mori pjesë në forumin e parë të Këshillit Kombëtar të Shkencës që u mbajt të enjten në Prishtinë. Në këtë forum, ku ishin të pranishëm edhe zv.ministrja e MASHTI-it, Edona Maloku Bërdyna, shefja e Zyrës së Agjencisë së Austrisë për Zhvillim, Sandra Horina, si dhe përfaqësues të Universiteteve dhe Instituteve të Kosovës, u diskutua për përmbajtjen dhe kushtet e zhvillimit të Programit Kombëtar të Shkencës.

Synimi i këtij forumi ishte që duke u bazuar në shkëmbimin e përvojave, duke përfshirë sukseset, sfidat dhe mësimet e nxjerra, t'i ofroj qeverisë udhëzime dhe rekomandime për zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës, dhe mbështetje për strategjitë kombëtare të zhvillimit.



## QENDRA PËR INOVACION DHE NDËRMARRËSI NË UIBM U SHNDËRRUA NË STORIE SUKSESI NË GJITHË KOSOVËN

27/04/2022

Qendra për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), është shndërruar në një storie suksesi duke mbetur si e vetmja që ka mbijetuar dhe vazhduar të funksionoj në Kosovë. Kështu u vlerësua kjo qendër në aktivitetin për shënimin e “Ditës Botërore të Inovacionit”, që u mbajt në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ku ishin të pranishëm edhe kryeministri, Albin Kurti si dhe ministrja, Rozeta Hajdari.

Drejtori i Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi në UIBM, Besart Hajrizi, shprehu kënaqësinë për vlerësimin sa i përket punës së kësaj qendre. Sipas tij, kjo është e vetmja qendër e këtillë që ka mbijetuar dhe ka vazhduar funksionimin në vend. “Në këtë qendër organizohen trajnime për studentë dhe të rinj, duke ofruar mundësi për ngritjen e tyre profesionale në lëmi të ndryshme”, tha ai.



## UIBM PRANOHET NË ASOCIACIONIN EVROPIAN TË UNIVERSITETEVE

04/05/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është pranuar në Asociacionin Evropian të Universiteteve (EUA), si anëtar individual i këtij asociacioni. Aplikimi i UIBM është miratuar nga Këshilli i EUA më 27 prill 2022.

Në njoftimin që i është dërguar rektorit të UIBM, prof.dr. Alush Musaj, shprehet gatishmëria për bashkëpunim në fusha të ndryshme me rëndësi për jetën akademike. Gjithashtu EUA falënderon interesimin e UIBM për të qenë pjesë e këtij asociacioni.

Rektori, prof.dr. Alush Musaj, shprehu kënaqësinë për pranimin si anëtar individual në Asociacionin Evropian të Universiteteve. “Është padyshim një lajm i mirë për UIBM, meqë përditë e më tepër po hapen mundësi të reja për bashkëpunim me organizata dhe universitete prestigjioze në Evropë dhe më gjerë”, tha ai.



## FILLOI FUSHATA INFORMUESE PËR PROGRAMET E STUDIMIT NË UIBM

05/05/2022

Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), në bashkëpunim me Parlamentin Studentor dhe përfaqësuesit e njësive akademike, ka filluar të enjten fushatën informuese për programet e studimit nëpër shkollat e rajonit të Mitrovicës. Në ditën e parë janë mbajtur takime informuese me maturantët e Shkollës Teknike në Mitrovicë, Shkollës Teknike, Shkollës Profesionale dhe Gjinnazit në Vushtrri.

Alban Fazliu, zyrtar i lartë QZHK-së, tha se maturantët janë informuar në detaje për programet dhe kushtet e studimit në UIBM. “Gjatë këtyre takimeve janë shfaqur video informuese për programet e studimit, kampusin dhe kushtet që ofrohen në UIBM. Gjithashtu janë shpërndarë edhe broshura informuese”, tha ai.



## U PROMOVUA LIBRI I ISH-PRESIDENTIT, BAMIR TOPI, “BETEJAT E HUMBURA TË TIRANËS”

06/05/2022

Organizuar nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është promovuar të premtën libri “Betejat e humbura të Tiranës”, me autor, ish-presidentin e Shqipërisë, Bamir Topi. Në promovim ishin të pranishëm edhe rektorë nga universitetet tjera publike, profesorë, studentë si dhe dashamirës të librit.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, falënderoi autorin e librit që ka zgjedhur këtë mjedis akademik për promovimin e librit të tij. “Vetë prania juaj sot këtu është ngjarje për universitetin tonë, ndërsa promovimi i librit tuaj është një mundësi më shumë për ne të gjithë dhe veçanërisht për studentët që të komunikojnë me ju dhe me Tiranën nëpërmjet librit tuaj”.

Sipas tij, Tirana, Shkodra, Kruja..., vazhdojnë të tingëllojnë magjishëm edhe në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë. “Duke filluar nga vetë titulli intrigues i librit “Betejat e humbura të Tiranës”, bëhemi kureshtar të kalojmë kaptinat e tij që kanë kapur momente kyçe të rrugëtimit të kryeqytetit shqiptar”.



## PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT EKONOMIK – PRILEP TË UNIVERSITETIT “SAINT KLIMENT OHRIDSKI” VIZITUAN UIBM

10/05/2022

Në kuadër të objektivave të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për rritjen e numrit të bashkëpunimeve me institucione të arsimit të lartë, rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, prof.ass.dr. Merita Shala si dhe dekani i Fakultetit Ekonomik, prof.asoc.dr.Qazim Tmava, kanë pritur në takim përfaqësues të Fakultetit Ekonomik – Prilep të Universitetit “Saint Kliment Ohridski” – Bitola të Maqedonisë së Veriut. Nga Fakulteti Ekonomik i Prilepit në takim të pranishëm ishin dekanja e Fakultetit Ekonomik, prof.dr.Dragica Odzaklieska si dhe prodekanja e Fakultetit Ekonomik të Prilepit, prof.dr.Tatjana Spaseska. Gjate takimit ishin të pranishëm edhe prof.ass.dr. Filloreta Kunoviku Demiri dhe prof. Milaim Mehmeti.

Në takim u diskutuan çështje me interes të përbashkët siç janë shkëmbimi i stafit dhe studentëve ndërmjet dy institucioneve, bashkëpunimi për aplikim në programe të përbashkëta të studimeve, organizimi i konferencave shkencore të përbashkëta si dhe ndër shumë çështje tjera edhe themelimi i një reviste shkencore të përbashkët.





## PËRMBYLLET FUSHATA INFORMUESE NËPËR SHKOLLAT E MESME PËR MUNDËSITË E STUDIMEVE NË UIBM

13/05/2022

Ka vazhduar fushata informuese nëpër shkollat e rajonit të Mitrovicës për programet dhe kushtet e studimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) për vitin akademik 2022/23. Në këtë kuadër të premtën janë mbajtur takime informuese me nxënësit e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Xheladin Deda” në Mitrovicë si dhe me nxënësit e shkollave të mesme në Komunën e Skenderajt. Fushata informuese është organizuar nga Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun, përkatësisht Qendra për Zhvillim në Karrierë së bashku me Parlamentin Studentor dhe Këshillat e Studentëve nëpër njësi akademike. Gjatë kësaj fushate, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga fakultetet, janë realizuar vizita dhe janë mbajtur takime informuese nëpër të gjitha shkollat e mesme të Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajt.



## UIBM PËRFAQËSOHET ME EKIPE NË FUTSALL DHE PINGPONG NË KAMPIONATET E SPORTEVE UNIVERSITARE

13/05/2022

Ekipet e studentëve në futsal dhe pingpong janë duke vazhduar ta përfaqësojnë Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) në kampionatet e organizuara nga Federata e Sporteve Universitare të Kosovës (FSUK). Pjesë e kampionateve në sporte të ndryshme janë ekipe nga të gjitha universitetet publike dhe nga dy kolegje private.

Të dyja ekipet e studentëve të UIBM janë duke treguar lojëra të mirë, përderisa ekipi i pingpongut aktualisht gjendet në vendin e tretë në tabelë. Studentët shprehën të kënaqur me organizimin dhe atmosferën e kampionateve universitare.

Avdyl Beqiri, anëtar i Bordit të FSUK, tha se interesimi i studentëve për t’u bërë pjesë e kampionateve në sporte të ndryshme vazhdon të jetë i mirë. Sipas tij, lojërat zakonisht mbahen në palestrën “1 Tetori” në Prishtinë dhe deri me tani gjithçka ka shkuar mirë.



## UIBM DO TË BËHET PJESË E PROJEKTEVE NDËRKOMBËTARE TË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”

19/05/2022

Universiteti “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë (UOGJ) ka ofruar mundësi për Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) që të bëhet pjesë në secilin projekt ndërkombëtar që aplikojnë. Këtë zotim e dha rektori i UOGJ-së, prof. dr. Bektash Mema, gjatë pritjes së një delegacioni nga UIBM, të përbërë nga rektori, prof. dr. Alush Musaj, prorektori, prof.dr. Behxhet Shala dhe dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, prof.dr. Milaim Sadiku.

Rektori Mema theksoi se UOGJ ka krijuar një përvojë të mirë sa i përket projekteve ndërkombëtare, që kanë krijuar mundësi të mëdha si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. “Megjithëse universitetet tona janë në dy skajet e trojeve shqiptare, në jug dhe veri, mundësitë e bashkëpunimit me përfitime reciproke janë të shumta”, tha ai.




## TAKIM I GRUPIT PUNUES PËR RISHIKIMIN E PLANIT STRATEGJIK (2022 -2025) TË UIBM

28/05/2022

Grupi punues për rishikimin e Planit Strategjik (2022 – 2025) të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ka mbajtur një takim të përbashkët me grupet përgjegjëse për objektivat e këtij plani. Në takim u diskutua për harmonizimin e propozimeve që janë dhënë pas punës së grupeve përgjegjëse për secilën nga objektivat veç e veç.

Koordinatori i grupit punues për rishikimin e Planit Strategjik (2022-2025), prof.dr. Ylber Januzaj, falënderoi të gjithë bartësit dhe anëtarët e grupeve për punën dhe kontributin e tyre. “Është bërë një punë e mirë prej të gjitha grupeve, ku kanë qenë të përfshirë prej menaxhmentit, stafit akademik, studentëve, administratës dhe biznesit”.

Sipas tij, pas miratimit të draftit të këtij plani në Këshillin Drejtues, ai do të vihet në diskutim publik. “Në fund të këtij procesi presim që ta kemi një dokument tepër të rëndësishëm që do të jetë udhërrëfyes për universitetin tonë për periudhën 2022 -2025”, tha ai.



## SHQYRTOHEN MUNDËSITË QË OFROHEN PËR STUDENTËT DHE STAFIN AKADEMIK NGA NJË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET AMBASADËS AMERIKANE DHE MASHTI-IT

03/06/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) synon të përfitoj nga programi Fulbright, në kuadër të një Memorandumi Bashkëpunim ndërmjet Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Për të biseduar për mundësitë që ofrohen për universitetet nga kjo marrëveshje, të premtën qëndruan në UIBM Qamile Sinanaj, udhëheqëse në Divizionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në MASHTI dhe Remzije Potoku, specialiste për Edukimin e Lartë në Ambasadën Amerikane.

Ato u pritën në takim nga prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr. Behxhet Shala dhe prorektorja për Buxhet dhe Financa, Ajtene Avdullahi, të cilët shprehën interesimin për mundësitë që ofrohen nëpërmjet kësaj marrëveshje për studentët dhe stafin akademik në UIBM. Marrëveshja synohet të nxit bashkëpunimin e institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja shtetet, inkurajon përmirësimin e kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, mësimeve dhe studentëve si dhe promovon projekte kërkimore të përbashkëta.



## HERAS+ ORGANIZOI PUNËTORI DY DITORE PËR STAFIN AKADEMIK TË UIBM-SË NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E CILKIT TË PROJEKTIT

07/06/2022

Projekti Heras Plus mundësoi një punëtori dyditore të përshtatur për Menaxhimin e Ciklit të Projektit (MCP) për Universitetin “Isa Boletini”-Mitrovicë.

Punëtorja u krijua së bashku nga ekipi HERAS Plus dhe udhëheqësia e UIBM-së. Aktiviteti u ndoq nga 20 pjesëmarrës të stafit akademik, i mbikëqyrur nga Rektori i UIBM, Prof. Dr. Alush Musaj.

Punëtorja e personalizuar kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të një ekipi të përzgjedhur të stafit akademik të UIBM për shkrimin, monitorimin dhe zbatimin e projekteve.

Programi kishte për qëllim të mbuloj të gjitha lëndët kryesore të përfshira në MCP, ndërsa metodat e zhvillimit ishin përmes prezantimeve, punës në grup dhe sesioneve të trajnimit.

Trajnimi është pjesë e mbështetjes që i jepet UIBM-së bazuar në fondin konkurrues për zhvillimin strategjik të universiteteve publike dhe është në përputhje me veprimet e përbashkëta të dakorduara në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Projektit HERAS Plus dhe Universitetit.

HERAS Plus financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe bashkëfinancohet nga MESTI dhe zbatohet nga WUS Austria, Zentrum für Soziale Innovation – ZSI dhe OeAD.



PROJEKTI I UIBM-SË EQUALITY THROUGH EDUCATION – RAISING AWARENESS OF THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES I MBËSHKETUR NGA ANA E HERAS+ ËSHTË DUKE VAZHDIKUR AKTIVITETET E TIJ TË RREGULLTA

08/06/2022

Takimet e deritanishme kanë pasqyruar gatishmërinë e ekipit implementues të projektit dhe të partnerëve për të kuptuar gjendjen reale të personave me aftësi të kufizuara dhe nevojat me të cilat përballen ata. Kjo do të mundësohet përmes selektimit të fokusgrurit të studentëve dhe implementimit të një pyetësi me ta dhe me asistentet nga radhet e stafit akademik.

Në këto takime, poashtu, është konfirmuar se UIBM edhe përmes këtij projekti respekton diversitetin dhe në mesin e grupeve të punës përfshinë student dhe palë tjera të interes.

Projekti do të vazhdojë me aktivitetet e parapara deri në përpmbylljen e tij në tetor të këtij viti. UIBM, pëveç shumë sferave tjera, përmes këtij projekti mbetet i përkushtuar për të shërbyer sa më shumë në komunitet.



## U MBAJT MBLEDHJE KOMEMORATIVE PËR PROF.DR. ISA TAHIRIN

09/06/2022

Drejtues të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), mësime, studentë, miq dhe familjarë, kanë marrë pjesë të enjten në Mbledhjen Komemorative kushtuar profesorit, Isa Tahiri, i cili u nda nga jeta më 6 qershor 2022. I ndjeri ishte profesor në Fakultetin Ekonomik në UIBM dhe vdekja e gjeti në moshën 64 vjeçare.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, tha se Universiteti “Isa Boletini”, ka pasur fatin dhe privilegjin që në mesin e stafit akademik ta ketë një mësime sikur profesor Tahiri, me një sfond të pasur shkencor e intelektual. “Ai u nda papritmas prej nesh, prej studentëve, prej familjes. Neve do të na mungojë kolegu korrekt, studentëve pedagogu i përkushtuar, ndërsa familjes kryefamiljari shembullor. Ai gjithsesi do t’i mungojë jetës akademike në Kosovë, duke pasur parasysh kontributin e tij në këtë aspekt”.





## KONFERENCA E REKTORËVE MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

13/06/2022

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Kosovës, ka zhvilluar të hënën mbledhjen e radhës e cila u mbajt në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Në takim u diskutuan ecuritë e përfundimit të semestrit veror në të gjitha universitetet pjesëmarrëse të konferencës.

Pikë tjetër diskutimi, në këtë mbledhje të kryesuar nga rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, ishte edhe përgatitja për pranimin e studentëve të rinj për vitin e ardhshëm akademik 2022/2023. Pjesëmarrësit u pajtuan se edhe këtë vit si sfidë e përbashkët e arsimit të lartë në Kosovë është trendi negativ i numrit të studentëve të interesuar për regjistrim.



## STAFI I UIBM PJESË EDHE I NJË AKSIONI TË COST-IT

14/06/2022

Një nga stafi akademik i UIBM-së (Ass. Bastri Zeka – FGJ) ka marr aprovimin për të qenë pjesë në dy grupe të hulumtimit në kuadër të Aksionit COST CA20130, i cili do të zgjas deri në vitin 2025. Ky Aksion udhëhiqet nga Instituti Federal për Kërkimin dhe Testimin e Materialeve (BAM)- Departmenti i materialeve dhe mjedisit në Berlin – Gjermani.

Qëllimi dhe objektivi kryesor i Aksionit është që, në kontekstin e kërkimit/kontrollit të Korrozionit të ndikuar Mikrobiologjikisht (MIC – ang.), të inkurajojë një bashkëpunim dhe komunikim sinergjik, duke mbyllur hendekun midis shkencëtarëve dhe inxhinierëve të materialeve, mikrobiologëve, kimistëve dhe menaxherëve për të inkurajuar ndërveprim të mjaftueshëm midis akademise dhe industrise.



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME ADRC – MCM KUADËR TË PROJEKTIT “DREJT LEHTËSIMIT TË QASJES NË DREJTËSI NË VERI TË KOSOVËS”

14/06/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) dhe organizata Alternative Dispute Resolution Center – Mediation Center Mitrovica (ADRC – MCM), do të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet në kuadër të projektit “Drejt lehtësimit të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës”. Për këtë qëllim u nënshkrua edhe një Memorandum Bashkëpunimi nga rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj dhe Zana Syla, koordinatore e projektit.

Memorandumi synon të promovojë përpjekjet e përbashkëta të dy palëve në avancimin e çështjeve me interes reciprok. Palët do të bashkërendojnë aktivitetet në drejtim të promovimit dhe afirmimit të programit të praktikës për jurist të rinj të paraparë në kuadër të projektit “Drejt lehtësimit të qasjes në drejtësi në veri të Kosovës” të mbështetur nga National Endowment for Democracy.



## TAKIM KONSULTATIV ME BORDIN INDUSTRIAL PËR PLANIN STRATEGJIK (2022 – 2025)

14/06/2022

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e Planit Strategjik (2022- 2025) të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), të martën u mbajt një takim konsultativ me Bordin Industrial. I pranishëm në takim ishte edhe rektori, prof.dr. Alush Musaj, i cili falënderoi të pranishmit për kontributin e tyre sa i përket hartimit të Planit Strategjik të UIBM.

Ai theksoi se Plani Strategjik është dokumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e Universitetit, duke pasur parasysh se përcaktimi i objektivave realizohet në bashkëpunim me shumë akterë. “Bashkëpunimi me biznesin është rritur gradualisht viteve të fundit dhe kjo patjetër se prodhon rezultate të prekshme dhe përfitime të gjithanshme”, tha ai.

Në anën tjetër, kryetari i Bordit Industrial, Visar Idrizi, përgëzoi rektorin Musaj dhe gjithë bashkëpunëtorët e tij për qasjen ndaj bizneseve. “Kemi parë një hapje të Universitetit ndaj nesh si biznese. Ne jemi shumë të interesuar që rrisim bashkëpunim me interes reciprok”, tha ai.



## UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”, PËR TË PESTIN VIT ME RADHË PA ASNJË VËREJTJE NGA AUDITIMI

21/06/2022

Për të pestin vit me radhë nuk është gjetur asnjë vërejtje nga Zyra Kombëtare e Auditimit sa i përket menaxhimit financiar në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Kjo konkluzë ka dalur nga raporti i publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore (2021) për Ministrinë e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), gjegjësisht për nënprogramet që funksionojnë në kuadër të kësaj ministrie, pjesë e të cilës është edhe UMIB-i.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, tha se tashmë është krijuar një traditë e menaxhimit të mirë në këtë institucion. “Me këtë rast dua ta përgëzoj Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe të gjithë punëtorët e administratës për punën e tyre profesionale”.



## REKTORI MUSAJ, PRITI NË TAKIM DREJTUESIT E ERASMUS+

01/07/2022

Mundësitë që ofron programi Erasmus+ vlerësohen shumë të rëndësishme për Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Për këto dhe çështje të tjera që ndërlidhen me projektet e Erasmus+ u bisedua të premtën në një takim të përbashkët që u zhvillua në UIBM ndërmjet rektorit, prof.dr. Alush Musaj dhe koordinatores së re të Zyrës Erasmus+ në Kosovë, Mimika Dobroshi dhe përfaqësueses së zyrës, Blerinë Zjaça.

Rektori Musaj, i cili në takim shoqërohej edhe nga prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, prof. ass. dr. Merita Shala dhe prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr. Behxhet Shala, uroi koordinatoren e Erasmus+ për detyrën e re dhe vlerësoi mbështetjen për intensifikimin e bashkëpunimit. “Jemi shumë të kënaqur me mundësitë dhe qasjen tuaj korrekte sa i përket bashkëpunimit”, tha ai.



## RIAKREDITOHEN TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT NË UIBM QË KANË QENË NË PROCES

04/07/2022

Të gjitha programet e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), që sivjet ju kanë nënshtruar procesit janë riakredituar në një periudhë 3 – vjeçare. Kjo është vendosur nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, që ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit për programet e UIBM-së.

Kanë qenë gjithsej 7 programe nga UIBM që këtë vit kanë kaluar nëpër procesin e riakreditimit: Biznes dhe Menaxhment (Bsc), Xehetari (Bsc), Teknologji (Bsc), Vendburimet Minerale (Msc), Xehetari (Msc), Teknologji dhe Inxhinieri (Msc) dhe Teknologji Ushqimore (Bsc). Prej tyre 4 programe kanë qenë në nivelin bachelor dhe 3 në atë master.



## EKIPI MONITURUES NGA HERAS+ VLERËSON LARTË PROGRESIN NË PROJEKTIN E UIBM-SË 'EQUALITY THROUGH EDUCATION – RAISING AWARENESS OF THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES'

05/07/2022

Sot është mbajtur takimi mes ekipit implementues të projektit 'Equality through education – raising awareness of the rights of persons with disabilities', projekt i realizuar nga UIBM dhe mbeshtetur nga HERAS+, me ekipin monitorues të HERAS+ në përbërje nga znj. Louise Spel, z.Nehat Dervishi dhe znj. Jeta Rexha dhe ekipit implementues të projektit.

Ekipi nga HERAS+ në takimin e vlerësimit të progresit të projektit është takuar me anëtarët e ekipit implementues të tij në përbërje: Prof.ass.dr. Zahir Çerkini – koordinator i projektit, Prof.ass.dr. Filloreta Demiri – asistent koordinatorë e projektit, Prof.asoc.dr. Ajtene Avdullahi anëtare në projekt dhe znj. Hiljmnijeta Apuk – si Drejtoresh – si Drejtoreshë e organizatës partnere në projekt. Ekipi nga UIBM ka njoftuar zyrtarët nga HERAS+ me ecurinë e deri tanishme të projektit, si dhe me hapat tutje nëpër të cilat do të kalohet.





## U MBAJT TRYEZA PËR TË TASHMEN DHE TË ARDHMEN E SEKTORIT MINERAR NË KOSOVË

14/07/2022

Investimet e huaja direkte janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e industrisë minerare në Kosovë. Kështu u vlerësua në tryezën: “E tashmja dhe e ardhmja e sektorit të minierave në Kosovë – analizë e investimeve të huaja direkte (IHD)”, që u mbajt të enjten në Fakultetin e Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM).

Ndër rekomandimet që dolën në fund, ishte edhe ai për drejtuesit e institucioneve, prej të cilëve u kërkua krijimi i konsensusit politik, zhbllkimi i të gjitha zonave për hulumtime, politika tatimore dhe ndarja e të ardhurave ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithashtu u vlerësua shumë e nevojshme që të mblidhen të gjithë ata që vendosin për politikat minerare në vend për t'i dhënë udhë zhvillimit të mëtutjeshëm të sektorit minerar dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte.



## NJË DELEGACION NGA UNIVERSITETI I KRAKOVËS VIZITOI FAKULTETIN E GJEOSHKENCAVE

18/07/2022

Një delegacion nga AGH Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë, Krakovë, Poloni (Fakulteti i Gjeologjisë, Gjeofizikës dhe Mbrojtjes së Mjedisit), i prirë nga prof. asoc. dr. Jaroslav Prsek, ka qëndruar për vizitë në Fakultetin e Gjeoshkencave (FGJ) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të këtyre dy fakulteteve nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe Universiteti i Krakovës.

Delegacioni u prit në takim nga dekani i FGJ-së, prof. dr. Naser Peci i shoqëruar nga prof. dr. Gani Maliqi, ku u diskutua për mundësitë e avancimit të bashkëpunimit, me theks të veçantë në projekte të përbashkëta si dhe mundësinë e mobilitetit të stafit dhe studentëve. Kolegët nga Polonia i dorëzuan FGJ -së edhe disa mostra nga vendburimet e Polonisë që mund të përdorin studentët dhe stafi për njohjen me të mirë të vendburimeve.

Delegacioni nga Polonia, pjesë e të cilit ishin edhe 5 studentë të nivelit master të Programit Gjeologjia Ekonomike, po zhvillon vizita studimore nëpër vendburime dhe zona gjeologjike të caktuara të Kosovës.



## NË UIBM PLANIFIKOHET ORGANIZIMI I NJË SEMINARI PËR EDUKIM MEDIAL

19/07/2022

Studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të mund të ndjekin seminarin për edukim medial që planifikohet të organizohet nga OSBE – ja në fillim të vitit akademik 2022/23. Për këtë u bisedua të martën në një takim në UIBM, ndërmjet rektorit, prof.dr. Alush Musaj dhe Lekë Berishës nga Seksioni i Mediave në Departamentin e Demokratizimit në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/OSCE).

Rektori Musaj, i cili në takim shoqërohej edhe nga prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, prof.ass.dr. Merita Shala si dhe prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr. Behxhet Shala, vlerësoi se seminari për edukim medial është një mundësi shumë e mirë për studentët, por edhe për stafin akademik. Ai theksoi se UIBM do të krijojë të gjitha kushtet që ky seminar të zhvillohet sa më mirë që është e mundshme në mënyrë që edhe interesimi i studentëve të jeta sa më i madh.



## NDEROHEN ME MIRËNJOHJE STUDENTËT DHE PROFESORËT QË E KANË PREZANTUAR UIBM NË GARËN “UNIVERSITY LAW COMPETITION 2022”

20/07/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, ka nderuar me mirënjohje një grup studentësh dhe profesorësh nga Fakulteti Juridik, të cilët marrë pjesë në garën “University Law Competition 2022” që është mbajtur në Tiranë. Ai ka uruar studenten Florijana Beka, e ka cila ka dalur fituese e çmimit të oratorisë “Best Speaker” dhe gjithë grupin që e ka prezantuar UIBM në garën mbarëkombëtare “University Law Competition 2022”, ku kanë marrë pjesë 16 universitete. Rektori Musaj, tha se kjo është një arritje e jashtëzakonshme për studentët, stafin akademik, Fakultetin Juridik në veçanti dhe Universitetin “Isa Boletini” në përgjithësi. “Prezantimi i suksesshëm dhe rezultati i arritur në këtë garë prestigjioze, në mesin e 16 universiteteve nga të gjitha trevat shqiptare, dëshmojnë përkushtimin tuaj si studentë në radhë të parë dhe mbështetjes dhe punës profesionale nga stafi akademik”, tha ai.



## U MBAJTËN PROVIMET PRANUESE NË UIBM

20/07/2022

Janë mbajtur të mërkurën provimet pranuese për kandidatët që kanë aplikuar në konkursin e shpallur për pranimin e studentëve në vitin e parë (bachelor) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) për vitin akademik 2022/23. Në 11 programe të akredituara në kuadër të 6 fakulteteve, kanë aplikuar gjithsej 625 kandidatë.

Interesimi më i madh si zakonisht ka qenë për programet shoqërore: Edukim, Juridik dhe Ekonomik, por edhe për programet në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, përderisa më pak për Teknologji Ushqimore dhe Gjeoshkenca. Për vendet që nuk do të plotësohen do të hapet afati i dytë i konkursit pranues.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, ka vizituar sallat ku janë zhvilluar provimet pranuese dhe ka uruar kandidatët që ju kanë nënshtruar provimeve. Ai ka theksuar se UMIB ofron programe atraktive që janë të kërkuara në tregun e punës si dhe një kampus modern.



PROFESORI BAHTIR HYSENI, PJESE E PUNËTORISË PËR HAPJEN E PROGRAMIT FULBRIGHT PËR ZHVILLIM TË FAKULTETEVE

25/08/2022

Profesori Bahtir Hyseni, aktualisht profesor në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore në UIBM, ishte në mesin e stafit të arsimit të lartë universitar nga Kosova që përfunduan punëtorinë e hapjes së programit Fulbright për zhvillim të fakulteteve. Punëtorja u organizuar në New York dhe në muajt e ardhshëm stafi akademik do të mësojnë qasjet më të mira praktike dhe teorike në zhvillimin e kurrikulës në universitetet nikoqire në SHBA.

Gjatë këtij programi stafi akademik do të hulumtoj dhe zhvilloj plane mësimore, syllabuse dhe strategji specifike të mësimdhënies që do implementohen në Kosovë.

Programi në fjalë është një program i përbashkët i Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Qeverisë së Kosovës dhe vazhdon të jetë i hapur edhe për pjesëmarrës tjerë nga stafi akademik të interesuar për shkëmbime akademike deri më datën 17.10.2022.



PROFESORI, GZIM IBISHI, VIJON STUDIMET E POST DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN BÜLENT  
ECEVIT

01/09/2022

Profesori i Fakultetit të Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof. ass. dr. Gzim Ibishi, ka filluar studimet e post- doktoratës në Universitetin Bülent Ecevit, në Zonguldak të Turqisë. Profesori Ibishi, i cili ligjëron në Departamentin e Xehetarisë, ka zgjedhur një fushë specifike të “Projektimit dhe Shfrytëzimit Nëntokësor”.

Ai hulumtimin do ta realizojë në kuadër të projektit “Underground rock excavation support design for static and dynamic loading conditions in different rock masses” nën udhëheqejn e Profesorit Melih Geniş, ekspert i njohur në lëmin e Gjeomekanikës së aplikuar dhe hapësirave nëntokësore. Brenda projektit të Post- doktoratës, do të realizohen punë në terren, punë laboratorike dhe aplikimi i softuerëve me të avancuar të fushës përkatëse për modelim dhe simulim.



## TAKIM I PËRBASHKËT I PROREKTORËVE ME PËRFAQËSUES TË PARLAMENTIT STUDENTOR TË UIBM

01/09/2022

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri akademik në UIBM, prorektorja për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë Merita Shala, prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore Behxhet Shala dhe prorektorja për buxhet dhe financa Ajtene Avdullahi u takuan me përfaqësuesit e parlamentit studentor, respektivisht kryetaren Ariona Rushiti dhe studentët Festim Murati dhe Arber Zeqiri.

Në takim u diskutuan çështje të lidhura me finalizimin e akreditimit të programeve për këtë vit akademik dhe përgatitjet e përbashkëta për procesin e riakreditimit institucional dhe të programeve për vitin e ardhshëm akademik. Aktivitetet e Parlamentit studentor, përgatitjet për fillimvitin e ri akademik, konkurset pranuese dhe studentët e rinj, si dhe çështje të tjera të lidhura me mësimdhënien, cilësinë, kërkimet, bashkëpunimin etj, ishin në fokus të diskutimeve dhe dakordimeve të përbashkëta për të rritur mundësitë që jeta akademike në universitetin tonë të jetë sa më e pasur dhe sa më në shërbim të studentëve tanë të ardhshëm dhe studentëve aktualë.





## PUNËTORI TRE DITORE PËR FINALIZIMIN E RAPORTIT TË VETËVLERËSIMIT NË UIBM

20/09/2022

Ka filluar të martën punëtorja tre-ditore për finalizimin e Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Pjesë e kësaj punëtorie janë të gjitha hallkat e UIBM - së, duke filluar nga rektori, prorektorët, dekanët, administrata dhe studentët. Gjatë tri ditëve do punohet në kapituj të ndarë veç e veç të RVV-së në mënyrë që të merr formën finale dhe të jetë i gatshëm për procesin e riakreditimit institucional që do të zhvillohet vitin e ardhshëm. Rektori, prof.dr. Alush Musaj, ka përgëzuar grupet që kanë punuar që disa muaj me radhë për këtë dokument të rëndësishëm për Universitetin.



## NJË PROFESOR NGA FINLANDA OFRON PËRVOJËN E TIJ PËR E-MËSIM NË UIBM

21/09/2022

Profesori, Hannu Viitala nga Universiteti Savonia në Finlandë do të mbajë një program trajnimi për e-mësimin në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Gjatë qëndrimit në UIBM ai do të mbajë kurse për Learning Management Systems (Moodle), Micro-courses: Online courses for lifelearning, E-learning tools and equipments dhe Game-based learning (Kahoot).

Profesor Viitala është pritur të mërkurën në takim nga rektori i UIBM, prof.dr.Alush Musaj, dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, prof.dr.Milaim Sadiku dhe asistenti, Arbër Hyseni. Ata i uruan mirëseardhje dhe e falënderuan profesorin nga Finlanda për pjesëmarrje në këtë kurs, ku do të ndaj përvojat më të mira sa i përket e-mësimit.



## FUQIZIMI I PARTNERITETIT ME BIZNESET, PRIORITET NË UIBM

*23/09/2022*

Në kuadër të aktiviteteve që zhvillon UIBM në shqyrtimin, analizimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, një hapësirë të posaçme zënë edhe takimet me përfaqësuesit e partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë. Duke i konsideruar si mjaft të vlefshme inputet nga eksperiencat e përbashkëta të bashkëpunimit qoftë në nivel të mundësive që ju krijohen studentëve tanë për zhvillimin e praktikës profesionale gjatë studimeve të tyre, apo ideve që synojnë përmirësim të përmbajtjes së programeve, takime të tilla si ky i radhës me z. Gani Durmishi, pronar i qumështores Aldi dhe Kryetari i shoqatës së industrisë së qumështoreve të Kosovës, synojnë zhvillimin e përbashkët meqenëse cilësia e studimeve dhe kompetencat me të cilat përgatiten studentët tanë përkthehen në angazhime cilësore kur ata punësohen nga bizneset.



## WORKSHOP ON HORIZON EUROPE PROJECT PROPOSAL WRITING

*23/09/2022*

On September 22nd, the Workshop on Horizon Europe Project Proposal Writing concluded successful proceedings. A group from UIBM participated in this workshop.

Alongside the support provided to the capacity building of the Kosovo NCP structure, training of young professionals on Horizon Europe, and incentivizing applications through the Horizon Europe Proposal Application Grant, HERAS Plus is also enhancing Kosovo's participation in Horizon Europe through tailor-made training on collaborative projects under Horizon Europe.

The Workshop on Horizon Europe Project Proposal Writing attracted a wide range of professionals from public and private Higher Education Institutions and civil society organizations. The training offered an overview of the Horizon Europe collaborative project actions and practical guidance on the application process.



## JANË MBAJTUR WORKSHOPET ME STUDENTËT NË KUADËR TË PROJEKTIT 'EQUALITY THROUGH EDUCATION – RAISING AWARENESS OF THE RIGHTS OF PERSONS WITH DISABILITIES'

27/09/2022

Më datë 23 dhe 26 shtator janë mbajtur dy workshope me studentët e UIBM-së për të drejtat ligjore për Personat me aftësi të kufizuar në kuadër të projektit 'Equality through education – raising awareness of the rights of persons with disabilities', projekt i implementuar nga UIBM dhe financuar nga HERAS+.

Temë diskutimi për dy ditë workshop me studentët ishin çështjet si: të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave me aftësi të kufizuar, sfidat e arsimimit të kësaj kategorie të shoqërisë, UIBM dhe qasja inkluzive në edukim e personave me aftësi të kufizuar, dhe jo vetëm. Ekipi i projektit ka pasur diskutime të frytshme me studentët, ku ka dëgjuar idetë dhe rekomandimet e tyre në lidhje me pozitën e Personave me aftësi të kufizuar.



U MBAJT CEREMONIA E DIPLOMIT PËR STUDENTËT QË KANË DIPLOMUAR NË VITIN AKADEMIK  
2021/22

28/09/2022

Ish – studentë, studentë, drejtues të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), mësimdhënës, familjarë etj, kanë marrë pjesë të mërkurën në Ceremoninë e Diplomimit për studentët që kanë diplomuar në vitin akademik 2021/22. Në UIBM është bërë traditë që nëpërmjet këtyre ceremonive për çdo vit akademik të festohet bashkërisht diplomimi i studentëve.

Duke ju drejtuar të pranishmëve, rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, uroi të diplomuarit dhe njëkohësisht shprehu kënaqësinë që bashkërisht me familjarë po festojnë suksesin e tyre. “Sigurisht që ky është një moment i veçantë për të diplomuarit, por gjithsesi është edhe një ndjenjë dhe përjetim emocional edhe për familjet dhe mësimdhënësit, me të cilët keni rrugëtuar së bashku gjatë viteve që keni studiuar këtu”.



## FILON IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT “STRENGTHENING LINKS BETWEEN ACADEMIC AND PROFESSIONAL DEVELOPMENT FOR STUDENTS OF THE FACULTY OF ECONOMICS – UIBM”

30/09/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë ka filluar implementimi i projektit “Strengthening links between academic and professional development for students of the Faculty of Economics – UIBM”, i cili financohet nga HERAS+. Ekipi i projektit është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar një implementim të suksesshëm të projektit.

Përmes këtij projekti synohet fuqizimi i lidhjes ndërmjet zhvillimit akademik dhe atij profesional për studentët e Fakultetit Ekonomik. Ideja e projektit është e bazuar në njohuri dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin e bashkëpunimit ndërmjet IAL dhe përfaqësuesëve nga tregu i punës. Për më tepër, ai synon të identifikojë nevojat e tregut të punës për fuqinë punëtore me qëllim përfshirjen e tyre në kurrikulat e programeve tona të studimit.



## PROFESORI PËRPARIM GRUDA PËRFUNDOI HULUMTIMIN E POST-DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN E GRACIT

03/10/2022

Profesori i Fakultetit Juridik Përparim Gruda ka përmbyllur fazën e hulumtimeve të post-doktoratës në Universitetin e Gracit, Fakultetin Juridik, Instituti i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në Austri.

Përgjatë periudhës të hulumtimeve atje, Profesor Gruda ka punuar në projektin “The Constitutional Relevance of the ECHR in Domestic Law: The Kosovo Perspective”.





## VITI AKADEMIK 2022/23 NISI ME CEREMONI PËR PRITJEN E STUDENTËVE TË RINJ

03/10/2022

Me rastin e fillimit të vitit akademik 2022/23, Parlamenti Studentor në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ka organizuar një ceremoni pritjeje për studentët e rinj. Pjesë e ceremonisë ishte edhe rektori, prof.dr. Alush Musaj, i shoqëruar nga prorektorët, dekanët, prodekanët, mësimdhënësit, drejtuesit e Parlamentit Studentor etj.

Rektori Musaj, ju uroi mirëseardhje studentëve të rinj në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. Ai shprehu mbështetjen e tij dhe të menaxhmentit, për studentët, në mënyrë që ata të jenë të suksesshëm. “Suksesi juaj është edhe suksesi ynë, është edhe suksesi i familjeve tuaja, të cilat presin t’i bëni krenarë me të arriturat tuaja”.



## PROGRAMI FULBRIGHT SPECIALIST PËR FAKULTETIN EKONOMIK, UIBM

06/10/2022

Në kuadër të projektit të fituar Fulbright Specialist Program, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Isa Boletini në Mitrovicë ka filluar angazhimin John McArdle – Profesori i Asociuar në Salem State University (SSU) in Massachusetts, SHBA. Fakulteti Ekonomik nga ky projekt fiton shërbime të konsulencës për rishikimin e programit ekzistues si dhe hartimin e programit të ri të studimit. Eksperti u mirëprit nga Rektori dhe Prorektorët, si dhe Dekani dhe stafi akademik i Fakultetit Ekonomik, UIBM.



## REKTORI MUSAJ, I SHOQËRUAR NGA PROREKTORËT DHE KRYETARJA E PARLAMENTIT STUDENTOR, KA VIZITUAR NJËSITË AKADEMIKE

06/10/2022

Me rastin e fillimit të vitit akademik 2022/23, rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, i shoqëruar nga prorektorët: Prof.ass. dr. Merita Shala, Prof. ass. dr. Ajtene Avdullahu dhe Prof.dr. Behxhet Shala dhe kryetarja e Parlamentit Studentor, Ariona Rushiti, kanë vizituar të gjitha njësitë akademike. Në takim me dekanët dhe prodekanët e fakulteteve, ai i ka uruar ata për fillimin e vitit të ri akademik dhe është interesuar lidhur me përgatitjet që janë bërë për semestrin dimëror.

Dekanët e kanë falënderuar rektorin dhe prorektorët për mbështetjen sa i përket nevojave që kanë njësitë akademike. Ata i kanë vënë në dijeni drejtuesit e UIBM se përgatitjet për vitin e ri akademik janë bërë me kohë dhe gjithçka ka nisur mirë dhe pa ndonjë problem.



## TRAJNIM PËR RRIJTJEN E AFTËSIVE KOMUNIKUESE TË STUDENTËVE

10/10/2022

Ka filluar të hënën trajnimi për rritjen e aftësive komunikuese me studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), që është organizuar nga Qendra për Zhvillim në Karrierë dhe GIZ-i. Ky trajnim mëton të ndihmojë studentët në rritjen e aftësive komunikuese dhe prezantuese, si parakusht për vetëprezantim më të mirë në ngjarjet që ofrojnë mundësi punësimi, përfshirë Panairin Kombëtar të Punës dhe Karrierës.

Përmbajtja e punëtorisë është konceptuar për të rritur aftësitë e vetë-prezantimit efektiv të pjesëmarrësve, duke përdorur “Elevator’s pitch” dhe teknika të ngjashme të rëndësishme për prezantim të shkurtër dhe efikas, si dhe seanca praktike përmes Role-play. Ndër të tjera në trajnim do të diskutohet për informacion mbi përmirësimin e aftësive komunikuese dhe prezantuese, prezantimet efektive, rregullat që duhen ndjekur për prezantime efektive etj.

Zyrtari i Lartë i Qendrës për Zhvillim të Karrierës, Alban Fazliu, falënderoi drejtuesit e GIZ-it për mundësinë që kanë krijuar për studentët e UIBM.



## FILLOI “KONFERENCA IV NDËRKOMBËTARE MULTIDISIPLINARE PËR GJEOSHKENCAT (IMGC 2022)”

13/10/2022

Ka filluar të enjten “Konferenca IV Ndërkombëtare Multidisiplinare për Gjeoshkencat (IMGC 2022)” në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), e cila zgjat dy ditë. Në këtë edicion që tradicionalisht organizohet nga Fakulteti i Gjeoshkencave në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë (Departamenti i Minerave dhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës) dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, janë planifikuar të paraqiten me kumtesa 38 referues.

Në mesin e atyre që do të paraqiten me kumtesat e tyre në Konferencë, përveç nga vendi dhe rajoni, ka edhe nga shtete të ndryshme evropiane, Kanadaja dhe Turqia. Në ditën e parë punimet do të zhvillohen në sesione të ndara, ndërsa në ditën e dytë pjesëmarrësit do të vizitojnë vende të ndryshme të Kosovës, duke filluar nga kampusi universitar në Mitrovicë, Minierën “Trepça” në Stan Tërg etj.



REKTORI MUSAJ, PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË,  
PROF.DR. NEKI FRASHËRI

13/10/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, dhe dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, prof.asoc.dr. Milaim Sadiku, kanë pritur në takim nënkryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof.dr. Neki Frashëri, akademikun, Ilijan Malollari dhe profesoreshën, Lorina Liqi. Mysafirët nga Shqipëria ishin pjesë e “Konferencës IV Ndërkombëtare Multidisiplinare për Gjeoshkencat (IMGC 2022)” që ka filluar të enjten në UIBM.

Rektori Musaj, i falënderoi mysafirët për pjesëmarrjen e tyre në këtë ngjarje të shënuar në UIBM, duke pasur parasysh karakterin e saj ndërkombëtar. Në anën tjetër, ata vlerësuan organizimin dhe punën e mirë që po bëhet në UIBM.

Në takim u bisedua për nevojën e bashkërendimit të aktiviteteve me karakter shkencor të universiteteve nga Shqipëria dhe Kosova.



## PROFESORI, GUVEN ONAL NGA TURQIA VLERËSON ORGANIZIMIN E MIRË TË KONFERENCËS PËR GJEOSHKENCË

14/10/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj dhe dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, prof.dr. Naser Peci, kanë pritur në takim profesorin, Guven Onal nga Turqia, president i Fondacionit për Zhvillim Minerar të Turqisë, i cili shoqërohej nga profesori, Habib Basholli. Takimi u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të Konferencës IV Ndërkombëtare Multidisiplinare për Gjeoshkencë (IMGC2022) që po mbahet në UIBM.

Konferenca për gjeoshkencë, u vlerësua si një aktivitet tradicional që tashmë ka bërë emër edhe në qarqet shkencore jashtë Kosovës. Profesori Onal, vlerësoi organizimin e mirë dhe mbarëvajtjen e kësaj Konference, që ka mbledhur studiues nga vende të ndryshme.

Gjithashtu në takim u bisedua edhe për organizimin e Kongresit Ballkanik të Pasurimit të Mineraleve, që mendohet të mbahet në maj në UIBM.



## ZV.MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, GETOAR MJEKU, VIZITOI PROJEKTIN E PANELEVE SOLARE NË UIBM

14/10/2022

Pasi ka marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së “Konferencës IV Ndërkombëtare Multidisiplinare për Gjeoshkencat (IMGC 2022)”, zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Getoar Mjeku, ka vizituar hapësirat e kampusit universitar. I shoqëruar nga rektori, prof.dr. Alush Musaj me bashkëpunëtorë, zëvendësministri ka vizituar edhe panelet solare të vendosura mbi objektin I, ku prodhohet energji për nevoja të UIBM.

Rektori Musaj e ka informuar zëvendësministrin për investimet në kampusin universitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me çka janë krijuar kushte të jashtëzakonshme pune. Gjithashtu ai e ka njoftuar Mjekun edhe për projektin e paneleve solare në UIBM, ku nëpërmjet tyre mbulohet një pjesë e shpenzimeve për energji.





## MBYLLET “KONFERENCA IV NDËRKOMBËTARE MULTIDISIPLINARE PËR GJEOSHKENCAT (IMGC 2022)”

15/10/2022

“Konferenca IV Ndërkombëtare Multidisciplinare për Gjeoshkencat (IMGC 2022)”, që u mbajtë me 13 dhe 14 tetor 2022 në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u vlerësua shumë e suksesshme nga ana e pjesëmarrësve. Pas ditës së parë ku u mbajtën sesionet e ndara sipas fushave të caktuara, në ditën e dytë pjesëmarrësit vizituan vende të ndryshme në Kosovë, si: “Punishtja e vjetër e minierës së Stan Tërgut”, “Muzeu i kristaleve të Trepçës” në Stan Tërg, “Shpella e mermerit” në Gadime dhe “Bifurkacioni i lumit Nerodime” në Ferizaj.

Në të gjitha këto vizita pjesëmarrësit u njoftuan edhe për karakteristikat dhe veçoritë e atyre vendeve. Aktiviteti zgjoi interesimin dhe kërkshërinë e pjesëmarrësve, që pos nga vendi dhe rajoni ishin edhe nga shtete të ndryshme evropiane etj.



## DEKANI PECI DHE PROFESORI ZEQRIRI MORËN PJESË NË “KONFERENCËN VIII SHKENCORE PODEK-POVEKS”

17/10/2022

Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, prof.dr. Naser Peci dhe shefi i Departamentit të Xehetarisë, prof.asoc.dr. Kemajl Zeqiri, kanë marrë pjesë në “Konferencën VIII shkencore PODEK- POVEKS”, në Ohër të Maqedonisë Veriore. Profesori Kemajl Zeqiri, prezantoi punimin e paraqitur paraprakisht, si dhe mori pjesë në njërin nga panelet e sesionit.

Ndërsa në margjina të Konferencës, dekani Peci dhe profesori Zeqiri, zhvilluan takime me rektorin e Universitetit të Shtipit “Goce Dolcev”, prof.dr. Dejan Mirakovski si dhe dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Teknikës, prof. dr. George Dimov. Në takim u diskutua për thellimin e bashkëpunimit reciprok dhe të dyja palët u pajtuan që në një ardhme të formalizojnë bashkëpunimin nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.



## NJË GRUP STUDENTËT TË PRIRË NGA DREJTUESIT E PARLAMENTIT STUDENTOR KANË VIZITUAR UNIVERSITETIN “UKSHIN HOTI” NË PRIZREN

19/10/2022

Drejtuesit e Parlamentit Studentor të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) të shoqëruar nga 35 studentë kanë realizuar një vizitë në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren (UKZ). Gjatë kësaj vizite ata kanë takuar kolegët e tyre në UKZ, mandej sekretarin e Përgjithshëm, Nexhmedin Krasniqi, prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë, prof.ass.dr. Arsim Susuri si dhe udhëheqësin e Qendrës për Zhvillim në Karrierë, Nehat Gashi.

Gjatë këtyre takimeve studentët e UIBM janë njoftuar me kushtet e punës, sfidat dhe të arriturat e UKZ – së. Gjithashtu është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Parlamenteve Studentore të të dyjave universiteteve.

Drejtuesit e PS -së kanë falënderuar studentët, drejtuesit dhe zyrtarët e UKZ – së për pritjen dhe gatishmërinë e bashkëpunimit.



## VIZITË NGA PJESËTARET E KËSHILLIT AMERIKAN DHE TË AMBASADËS AMERIKANE NË KOSOVË

19/10/2022

Stafi i Ambasadës Amerikane në Kosovë i prirur nga Zonjat Remzije Potoku dhe Nora Nimani-Musa vizituan sot Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë.

Ata takuan Rektorin Alush Musaj, Dekanin e Fakultetit Ekonomik Qazim Tmava, stafin akademik të Fakultetit Ekonomik në UIBM, si dhe ekspertin John McArdle Profesor në Salem State University (SSU) në Massachusetts, SHBA i cili po qëndron në Universitetin Isa Boletini në Mitrovicë.

Me këtë rast Rektori Musaj theksoi që kjo është hera e dytë që Universiteti Isa Boletini përfiton shërbime të konsulencës për rishikimin e programeve ekzistuese si dhe hartimin e programeve të reja të studimit nga Programi Fulbright Specialist.

Në këtë takim kordinatorja e projektit Fulbright Specialist Program për Fakultetin Ekonomik, Profesoresha Ajtene Avdullahi i njoftoi të pranishmit se eksperti John është mirëpritur nga menaxhmenti dhe i gjithë stafi i Fakultetit Ekonomik. Ata po bashkëpunojnë ngushtë në lidhje me rishikimin e programit ekzistues si dhe hartimin e programit të ri të studimit.



## PROF.ASS.DR. ILIR MAZREKU U ZGJODH KRYESUES I KËSHILLIT DREJTUES

21/10/2022

Prof.ass.dr. Ilir Mazreku është zgjedhur kryesues i Këshillit Drejtues në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2022. Për një vit këtë pozitë e ka mbajtur prof.dr. Salem Lepaja.

Ndërsa për detyrën e zëvendëskryesuesit të KD-së, besimin e ka marrë edhe për një vit, prof.asoc.dr. Gazmend Kaçaniku.



## STUDENTËT MITROVICAS VIZITUAN UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” NË DURRËS

*22/10/2022*

Një grup studentësh nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), të prirë nga kryetarja e Parlamentit Studentor, Ariona Rushiti, kanë vizituar Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Gjatë vizitës në Durrës, studentët mitrovicas janë shoqëruar edhe nga zyrtari i lartë i Qendrës për Zhvillim në Karrierë, Alban Fazliu dhe sekretari i Fakultetit Juridik, Abdyl Beqiri. Studentët janë pritur nga kolegët e tyre në Universitetin “Aleksandër Moisiu” si dhe nga drejtori i Administrimit dhe Shërbimit Akademik, Xhafer Rakiplari. Në takimet e zhvilluara është biseduar për bashkëpunimin si dhe shkëmbimin e përvojave të mira ndërmjet studentëve të të dy universiteteve. Në grupin e vizitorëve nga UIBM ka pasur studentë nga të gjitha njësitë akademike.



PARLAMENTI STUDENTOR ORGANIZOI AKTIVITET PËR SHËNIMIN E “TETORIT ROZË” – MUAJI I  
NDËRGJEGJËSIMIT PËR KANCER TË GJIRIT

24/10/2022

Parlamenti Studentor në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë ka organizuar të hënën një aktivitet simbolik për shënimin e “Tetorit Rozë” – muaji i ndërgjegjësimit për kancer të gjirit. Në këtë aktivitet që është mbajtur në hyrje të objektit 1, përveç studentëve ka marrë pjesë edhe rektori, prof.dr. Alush Musaj si dhe prorektorët, disa dekanë, mësimdhënës etj.

Kryetarja e Parlamentit Studentor, Ariona Rushiti, tha se nëpërmjet këtij aktiviteti kanë dashur që të bëhen pjesë e fushatës ndërgjegjësuese për kancerin e gjirit. “Kemi dashur gjithashtu që të senzibilizojmë edhe komunitetin universitar për “Tetorin Rozë” dhe me këtë rast falënderoj të gjithë ata që kanë marrë pjesë”, theksoi ajo.



## ZHVILLOHET SIMPOZIUMI: “ZHVILLIMI I MËSIMDHËNËSVE TË RINJ: SFIDAT DHE E ARDHMJA”

*26/10/2022*

Në 25 Tetor, në ambientet e fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës, u zhvillua simpoziumi: Zhvillimi i mësimdhënësve të rinj: Sfidat dhe e ardhmja.

Në këtë simpoziium, morën pjesë Prorektorja për mësimdhënie, cështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë prof.asoc.dr. Merita Shala, dekani i fakultetit të Edukimit prof.asoc.dr. Besim Gollopi dhe prodekania e fakultetit të Edukimit prof.ass.dr. Samire Bllaca Balaj.

Ky simpoziium u organizua në kuadër të projektit Erasmus Plus “Drejt një sistemi të orientuar në cilësi të përgatitjes së mësimdhënësve të rinj në Kosovë” (QATEK), nën udhëheqjen e Fakultetit të Edukimit në Prishtinë.





## TRUPI INDUSTRIAL I FAKULTETIT EKONOMIK TAKOHET ME “SPECIALISTIN E PROGRAMIT FULBRIGHT” PROF MCARDLE

27/10/2022

Trupa Industriale në kuadër të Fakultetit Ekonomik, së bashku me perfaqësues të bizneseve nga rajoni i Mitrovicës, mbajti takimin e radhës ku prezent ishte edhe Prof. John McArdle, profesor i asocuar në Salem State University (SSU) në Massachusetts, SHBA, i angazhuar në kuadër të projektit “Fulbright Specialist Program”. Takimin e udhehoqi z-nja Vesa Broja, kryesuese e Trupës Industriale, e cila e falenderoi profesorin McArdle, lidhur me mbështetjen e njësisë akademike si ekspert i konsulencës për rishikimin e programeve, si dhe hartimin e programeve të reja të studimit.

Përveq propozimit të programeve të reja, posaqërisht për nivelin master, në takim u diskutua edhe rreth mundësive të avansimit të bashkpunimit të njësisë akademike me bizneset, si dhe modelet e funksionimit të këtij bashkpunimi në ekonomitë e zhvilluara, konkretisht në SHBA, por edhe lidhur me ofrimin e ekspertizës akademike e profesionale në këtë aspekt.



NË UIBM MBAHET PUNËTORIA PËR QASJET E REJA NDAJ NDËRKOMBËTARIZIMIT DHE IMPLIKIMET E TYRE NË STRATEGJITË E UNIVERSITETEVE- QUADIC

27/10/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” Mitrovicë është mbajtur punëtorja për qasjet e reja ndaj ndërkombëtarizimit dhe implikimet e tyre në strategjitë e universiteteve.

Qëllimi i projektit ERASMUS+ QUADIC është të kontribuoj në ndërkombëtarizimin e universiteteve në Kosovë dhe Shqipëri. Përveq UIBM-së, në këtë projekt si partner nga Kosova janë edhe UKZ, UP, UPZ, UGJFA, UMIB, IBCM, HEIMERER dhe UBT. Partnere nga Shqipëria janë UET, UNIKO, UGJK, UAMD dhe UMT.

Partnere të Unionit Evropian siq: UNISTRAPG, Universiteti COTE D’E AZUR dhe Universiteti Teknik i Sofjes.



NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME TEKNIKE “ARKITEKT SINANI”- DREJTIMI TELEKOMUNIKACION,  
VIZITOJNË DIVIZIONIN E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË UIBM

27/10/2022

Nxënësit e Shkollës së Mesme Teknike “Arkitekt Sinani”- drejtimi Telekomunikacion, të shoqëruar nga profesorët e tyre, Ajet Musa dhe Nedime Dobreva, kanë vizituar divizionin e TI-së në UIBM, që udhëhiqet nga drejtori Lulzim Bunjaku. Nën demonstrimin e drejtorit Bunjaku dhe zyrtarit të lartë të TI-së Bardhyl Miftar, nxënësit patën mundësinë të njihen me pajisjet dhe aparaturat teknologjike që UIBM përdor për konferenca dhe organizime të ndryshme, menaxhimin dhe administrimin e rrjetit, serverëve dhe aparaturave tjera që kanë digjitalizuar universitetin dhe kanë lehtësuar qasjen e studentëve në shërbime elektronike. Ata poashtu patën rastin ta vizitojnë edhe bibliotekën universitare që është e pajisur me kompjuterë, literaturë online si dhe WiFi.



REKTORI MUSAJ DHE PROREKTORI SHALA MORËN PJESË NË SHËNIMIN E 65-VJETORIT TË  
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

27/10/2022

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, i shoqëruar nga prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, prof.dr. Behxhet Shala, ka marrë pjesë në shënimin 65-vjetorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Fillimisht delegacioni nga Mitrovica është pritur në takim nga rektorja e USHLG, prof.dr. Suzana Golemi.

Në takim u bisedua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy universiteteve. Në këtë kontekst, u vlerësua e rëndësishme shkëmbimi i stafit akademik dhe studentëve.

Rektori Musaj e ka falënderuar rektoren Golemi për pritjen dhe gjithashtu e ka uruar për 65 – vjetorin e themelimit të USHLG. “Është vërtet kënaqësi që jemi sot këtu bashkë për të festuar 65-vjetorin e Universitetit të Shkodrës, një vatre të dijes në gjithë hapësirën shqiptare”.



DEKANI DHE PRODEKANI I FIMK-UT PO MARRIN PJESË NË TAKIMIN FINAL RRETH PROJEKTIT ITEM  
NË CZECH TECHNICAL UNIVERSITY

28/10/2022

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike Prof. Asoc. Dr Faton Merovci së bashku me prodekanin e këtij Fakulteti prof.ass dr Muzafer Shala, po qëndrojnë në Czech Technical University në Republikën Çeke. Vizita është në kuadër të takimit final rreth projektit iTEM – Innovative Teaching Education in Mathematics, project i financuar nga Erasmus+. Koordinator lokal i këtij projekti Faton Merovci ka deklaruar se takimet janë zhvilluar me datën 26 dhe 27 tetor, ku ky është takimi përfundimtar rreth këtij projekti ku janë trajtuar përveç përmbjlljes së këtij projekti, raportimi dhe auditimi i tij si dhe mundësisë së bashkëpunimit me tutje për aplikime në projekte të përbashkëta. Pjesë e këtij projekti katërvjeçar kanë qenë universiteti të ndryshme nga shtetet si Greqia, Kosova, Danimarka, Suedia, Austria, Maqedonia e Veriut dhe Uzbekistani.



## NJË DELEGACION NGA UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA “VAN HALL LARENSTEIN” NGA HOLANDA QËNDROI NË FTU

*31/10/2022*

Në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (FTU) qëndruan zyrtarët për bashkëpunim ndërkombëtar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara “Van Hall Larenstein” nga Holanda. Delegacioni përbëhej nga: Ingrid de Vries, koordinatore e Erasmus-it dhe udhëheqëse e projektit për projektin aktual KA107, Johan de Velde, lektor i Menaxhimit të Zhvillimit Ndërkombëtar (IDM) dhe drejtues projekti, Arno de Snoo, menaxher Programi (IDM) dhe z. Koos de Vries, koordinator për Teknologji të Qumështit. Ata u pritën në takim nga dekani i FTU -së, prof. asoc. dr. Milaim Sadiku, prodekani për Cilësi dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, prof. asoc. dr. Mehush Aliu si dhe prof. ass. dr. Faruk Hajrizi dhe ass. mSc. Arbër Hyseni. Në takim u bisedua për planin e ri institucional dhe fokusin e Universitetit “Van Hall Lareinsten”, prezantimin e strukturës së re drejtuese dhe organizative, përfshirjen e UIBM në projektin KA 107 si dhe statusin e projektit aktual KA107.



## NË UIBM “TETORI ROZË” PËRMBYLLET ME NJË TRYEZË INFORMUESE

01/11/2022

Tetori Rozë – është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Kanceri i gjirit nuk zgjedh & Diagnostikimi i hershëm shpëton jetë! Quket “Tetori Rozë” pasi njerëzit në mbarë botën shfaqin një fjongo rozë për të rritur ndërgjegjësimin për shëndetin e gjirit dhe rëndësinë e shqyrtimit për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, tani kanceri më i diagnostikuar në mbarë botën.

Për të sensibilizuar dhe edukuar gratë dhe vajzat për rëndësinë e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit, në amfiteatrin e madh në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, u organizua një tryezë informuese.

Në këtë tryezë, i ftuari Dr. Saudin Maliqi, Kirurg torakal, ofroi informacione relevante dhe rekomandime specifike. Ndërsa znj, Selime Rexha Shkreta edukatore, ndau përvojën e saj jetësore, sfidat dhe përkrahjen e vazhdueshme që mori gjatë kësaj periudhe të kapërcimit të kësaj sfide shëndetësore.



## TAKIMI I MENAXHMENTIT TË UNIVERSITETIT “ISA BOLETINI” NË MITROVICË ME AGJENCINË STATISTIKORE TË KOSOVËS

04/11/2022

Menaxhmenti i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë në përbërje të prof. dr. Alush Musaj – Rektor, prof. asoc. dr. Merita Shala – prorektore për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë, prof. dr. Behxhet Shala – prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore, prof. asoc. dr. Bashkim Bellaqa – anëtar i Këshillit Drejtues të UIBM-së, pritën në takim drejtuesit e Agjencisë të Statistikave të Kosovës z. Ibrahim Rustemi – drejtor për bashkëpunim me jashtë, znj. Gillian Green, eksperte ndërkombëtare për mbështetje të statistikave të Kosovës, z. Bajrush Qevani – drejtor për statistika të bujqësisë.

Z. Ibrahim Rustemi, fillimisht shprehu falënderime dhe mirënjohje për pritjen e ngrohtë nga UIBM, duke njoftuar më për së afërmi me punën që bënë ASK-ja, duke u fokusuar në mundësinë e një bashkëpunimi në fushën e kërkimeve shkencore, angazhimit të stafit dhe studentëve në projekte kërkimore, qasjen e stafit në bazë të të dhënave, mundësinë e bashkëpunimit në hapjen e një programi për statistika, etj.





## U MBAJT MBLEDHJA E KOLEGJIUMIT TË DEKANËVE

07/11/2022

Në prani të rektorit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj si dhe prorektorëve, prof.ass.dr. Merita Shala, prof.ass.dr. Ajtene Avdullahi dhe prof.dr. Behxhet Shala, u mbajt të hënën mbledhja e Kolegjiut të Dekanëve. Në mbledhje, ku u diskutua për Raportin e Vetëvlerësimit (RVV), ishin të pranishëm të gjithë dekanët e gjashtë njësive akademike në UIBM. Përveç kësaj, u diskutua edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e riakreditimit institucional, përgatitjet dhe koordinimin e të gjitha mekanizmave universitar. Rektori Musaj, kërkoi përkushtim nga të gjithë në mënyrë që procesi i riakreditimit të shkojë sa më mirë. Gjithashtu u shtruan edhe tema të tjera që kanë të bëjnë me rrjedhën e procesit mësimor nëpër njësi akademike.



## ORGANIZOHET MODULI I PARË I TRAJNIMIT PËR STUDENTËT “EDUKIMI MEDIATIK”

09/11/2022

Në ambientet e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në kuadër të bashkëpunimit me Misionin e OSBE-së, u organizua seminari për përmirësimin e shkrim-leximit mediatik.

Seminaret, të cilët do të vazhdojnë, u ofrojnë studentëve pjesëmarrës aftësi kyçe të shkrim-leximit mediatik, duke u thelluar në tema specifike si zbulimi i lajmeve të rreme, roli i reklamës në ndërtimin e identiteteve, fëmijët si audiencë e veçantë mediatike, argëtimi në media dhe çështjet e privatësisë. Në seminarin e parë morën pjesë mbi 100 studentë nga fakultete të ndryshme të UIBM-së, veçanërisht nga Fakulteti i Edukimit.

Më tutje është paraparë që prodhimi i një kurrrikule gjithëpërfshirëse të arsimit mediatik për arsimin e lartë që është zhvilluar në vitin 2019 së bashku me Departamentin e Gazetarisë të UP-së, të integrohet si lëndë bazë, dhe Misioni i OSBE-së do të vazhdojë mbështetjen e arsimit të lartë në Kosovë. për të arritur këtë qëllim.



## NIS NDËRTIMI I FUSHAVE SPORTIVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR

10/11/2022

Dy fusha të hapura sportive, njëra e ndarë për futboll dhe tenis dhe tjetra për basketboll dhe volejboll, kanë nisur të ndërtohen në hapësirat e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Sipas projektit, fushat sportive do të ndërtohen me asfalt dhe do të kenë të gjitha pajisjet e nevojshme. Ky projekt do të realizohet në dy faza. Për fazën e parë që planifikohet të kryhet këtë vit janë ndarë 80 mijë euro nga kategoria e investimeve kapitale, ndërsa për fazën e dytë që do të vazhdojë në vitin tjetër do të ndahen edhe 80 mijë euro të tjera.




## U THEMELUA TRUPI KËSHILLËDHËNËS I FIMK

11/11/2022

Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), ka marrë vendim që të themelojë Trupin Këshillëdhënës për këtë njësi akademike. Kjo trupë përveç menaxhmentit të njësisë akademike ka në përbërje edhe përfaqësues nga institucionet tjera si dhe bota e biznesit.

Në ditët në vazhdim do të mbahet mbledhja konstituive, ku do të zgjedhet kryetari dhe organet tjera drejtuese. Në këtë kontekst, përbërja mund të pasurohet edhe më anëtarë të rinj.

Dekani i FIMK, prof.asoc.dr. Faton Mervoci, theksoi se kjo trupë do të jetë një mekanizëm mbështetës për fakultetin, për përshtatjen e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës etj.



AIS/ALBSA NDAN ÇMIMIN E EKSELENCËS PËR DEKANIN E FAKULTETIT TË EDUKIMIT, PROF. ASOC.  
DR. BESIM GOLLOPENI

15/11/2022

Komisioni i Vlerësimit të Kontributeve Akademike (AIS/ALBSA), me kryetar akademik Servet Pëllumbi (Tiranë), ka vlerësuar dhe ndarë ÇMIMIN e Ekselencës për Kërkim dhe Angazhim për Monografinë “Popullsia dhe migrimet në Kosovë – Rast studimi Suhareka” me autor Prof. Asoc. Dr. Besim Gollopeni, Dekan i Fakultetit të Edukimit pranë Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe për kontributin e spikatur institucional. Çmimin është dorëzuar nga Prof. Lekë Sokoli dhe Prof. Dukagjin Pupovci, zv. Ministër i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (Kosovë) në Konferencën Ndërdisciplinore Ndërkombëtare “Roli i teknologjisë në formësimin e shoqërisë” e cila u organizua me datat 11 dhe 12 nëntor 2022 në Universitetin Publik Kadri Zeka në Gjilan.



## U MBAJT SESIONI INFORMUES PËR THIRRJEN PËR BURSA (MASTER) NË BE

16/11/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është mbajtur të mërkurën një sesion informues në lidhje me thirrjen që do të hapet për bursa për studimet e nivelit master në shtetet e Bashkimit Evropian për vitin akademik 2022/23. Thirrja do të hapet në kuadër të projektit “Young Cell Scheme” – raundi XIII.

“Young Cell Scheme”, e nisur në vitin 2004 është kthyer dhe do të vazhdojë të ofrojë një mundësi për studentët e rinj në Kosovë për të studiuar në universitetet më të mira në shtetet anëtare të BE-së, duke ofruar një bursë njëvjeçare, dyvjeçare dhe mundësinë për përfituesin të punojë për shërbimin civil të Kosovës, pas përfundimit të programit.

Programi financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës dhe zbatohet nga Universiteti “Aristoteli” i Selanikut dhe INSP.



## U MBAJT TRYEZA PËR NEVOJAT E TREGUT TË PUNËS QË NDIKOJNË NË FUQIZIMIN E LIDHJES MIDIS ZHVILLIMIT AKADEMIK DHE PROFESIONAL PËR STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK

17/11/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) u mbajt të enjten një tryezë e rrumbullakët ku u diskutua për nevojat e tregut të punës që ndikojnë në fuqizimin e lidhjes midis zhvillimit akademik dhe profesional për studentët e Fakultetit Ekonomik. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues nga institucionet lokale dhe qendrore, organizata të ndryshme, biznese etj.

Dekani i Fakultetit Ekonomik, prof.dr. Qazim Tmava, ka falënderuar të pranishmit që kanë treguar interesim dhe kanë gjetur kohë për të marrë pjesë në këtë organizim. Ndërsa duke folur për temën e tryezës, ai theksoi se tashmë ndërlidhja ndërmjet universitetit – industrisë dhe qeverisë është imperativ i kohës që ndikon edhe në vetë zhvillimin shoqëror.

Ndërsa, rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, përgëzoi organizatorët e tryezës, dekanin e Fakultetit Ekonomik, Qazim Tmava, profesoreshën, Filloreta Demiri Kunoviku dhe të gjithë ata që kanë qenë pjesë e organizimit. Ai tha se ka qenë synim i vazhdueshëm prej fillimi që universiteti të integrohet fuqishëm si një katalizator i zhvillimit të shoqërisë, duke ofruar pjesën akademike.



U MBAJT TRYEZA E RRUMBULLAKËT ME TEMË: “VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMARRIM SI SHOQËRI  
NË ZHVILLIMIN E MËTUTJESHËM TË MBARË SHTETIT”

24/11/2022

Organizuar nga Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Edukimit në Universitetin “Isa Boletini“ në Mitrovicë (UIBM) është mbajtur të enjten një tryezë e rrumbullakët me temë: “Veprimet që duhet të ndërmarrim si shoqëri në zhvillimin e mëtutjeshëm të mbarë shtetit”. Kjo tryezë ku janë prezantuar 15 kumtesa të studentëve është organizuar me rastin e festave të nëntorit.

Panelistë ka qenë u.d. dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi dhe dekani i Fakultetit të Edukimit, prof. asoc.dr. Besim Gollopi. Ata fillimisht kanë falënderuar studentët e pranishëm për interesimin si dhe u kanë uruar festat e nëntorit: 28 Nëntorin – Ditën e Flamurit, Paraqitjen Publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ditëlindjen e Komandantit Legjendar, Adem Jashari.





## REKTORI DHE PROREKTORËT E UNIVERSITETIT "ISA BOLETINI" MARRIN PJESË NË SEMINARIN PËR BASHKËPUNIM NË PROGRAMIN ERASMUS+

24/11/2022

Rektori Musaj dhe Prorektorët e Universitetit Isa Boletini në Mitrovicë morën pjesë në seminarin për bashkëpunim në programin Erasmus+ ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë të Francës dhe atyre të Ballkanit Perëndimor, i cili u mbajt më 22-23 Nëntor 2022, në Tiranë, Shqipëri.

Ky seminar u organizua nga Agjencia Nacionale e Erasmus+ në Francë, në bashkëpunim me zyrat Erasmus+ të Ballkanit Perëndimor përfshirë këtu edhe Zyrën Erasmus+ në Kosovë. Ideja kryesore e këtij seminari ishte rritja e bashkëpunimit në Arsimin e Lartë në mes të vendeve pjesëmarrëse në program.

Pjesëmarrës në këtë seminar ishin institucionet e Arsimit të Lartë nga Franca si dhe përfaqësues të institucioneve të Arsimit të Lartë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.



## EKSPOZITË E STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT

24/11/2022

Me rastin e 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit në Fakultetin e Edukimit u hap të enjten një ekspozitë me punime të studentëve të këtij fakulteti. Ekspozita është përgatitur dhe hapur nën përkujdesjen e profesoreshës së artit, Saranda Kika.

Në hapje të ekspozitës ishte edhe rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, dekani i Fakultetit të Edukimit, prof.asoc.dr. Besim Gollopi, prorektorë, dekanë, mësimmhënës, studentë etj. Rektori Musaj dhe dekani Gollopi kanë uruar studentët për organizimin e kësaj ekspozite.

Kryetarja e Këshillit të Studentëve në Fakultetin e Edukimit, Gresa Tahiri, tha se kjo ekspozitë ka qenë një mundësi shumë e mirë për studentët që të shfaqin talentin e tyre në këtë fushë. Ndërsa, senatori student, Festim Murati, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në secilin aktivitet të organizuar nga Këshillet Studentore.



## PROF.ASOC.DR. ISLAM QERIMI ZGJEDHET DEKAN I FAKULTETIT JURIDIK

*25/11/2022*

Këshilli i Fakultetit Juridik në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2022, në mënyrë unanime ka zgjedhur prof.asoc.dr. Islam Qerimin dekan të kësaj njësie akademike. Sipas procedurave të rregullta, ky propozim i Këshillit të Fakultetit Juridik, i dërgohet për miratim Senatit të UIBM.

Zgjedhja e dekanit pason zgjedhjen e anëtarëve dhe mbledhjen konstituive të Këshillit të Fakultetit Juridik. Ndërsa zgjedhjet për Këshill të Fakultetit Juridik janë mbajtur më 18.11.2022, me vendim të Këshillit Drejtues të UIBM.



## QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS DHE PARLAMENTI STUDENTOR ORGANIZUARN LIGJËRATË PËR SHËNIMIN E DITËS NDËRKOMBËTARE PËR ELIMINIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE

29/11/2022

Në Fakultetin Juridik me rastin e 25 Nëntorit – Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) dhe Parlamenti Studentor i UIBM-së, organizuan një ligjeratë për trajtimin e kësaj teme.

Në këtë ligjeratë Mr. sc. Ramadan Beshiri, nga O.J.Q – Premisa, ligjërues i certifikuar nga Këshilli i Evropës dhe Akademia e Drejtësisë mbi modulën: Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, ka prezentuar të dhëna të shumta krahasuese sa i përket kësaj tematike nëpër periudha të ndryshme kohore në shoqërinë shqiptare si dhe në shoqëritë e huaja. Eksperti i kësaj fushe, Beshiri kritikoi pozitën e pabarabartë të gruas gjatë historisë njëllor qoftë tek ajo shqiptare apo e huaj. Ai shtoi se gruaja shqiptare ka luajtur një rol me rëndësi përgjatë historisë në zhvillimin dhe avancimin e shoqërisë dhe shtetit dhe ajo është edhe sot prezente në të gjitha instancat shtetërore. Mirëpo, një kritikë e veçantë ai pati sa i përket kufizimit të gruas në të drejtën e disponimit të pronës dhe të drejtës së trashëgimisë së pasurisë së paluajtshme si përgjatë historisë e edhe në kohën moderne.



## U MBAJT TRAJNIMI PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM NË MINIERA NGA KOMPANIA NETCAD MINING SOLUTIONS

*29/11/2022*

Në bashkëpunim me Fakultetin e Gjeoshkencave dhe kompaninë NetCAD Mining Solutions është mbajtur trajnimi 3 ditor (23.11.2022 – 25.11.2022) për aplikueshmërinë e programit në fushën e Planifikimit dhe Projektimit Minerar. Trajnimi është udhëhequr nga eksperti i kompanisë së NetCAD, Emre Gokyer.

Profesori Gzim Ibishi, tha se qëllimi i trajnimit është t'iu mundësoj stafit akademik të kenë çasje bashkëkohore në fushën e Planifikimit dhe Projektimit. Vlenë të thekësohet se falë bashkëpunimit të arritur në mes të Universiteti Isa Boletini në Mitrovicë dhe Universitetit “Zonguldak Bulent Ecevit University” në Turqi, është mundësuar përmes personelit akademik nga Turqia që edhe Fakulteti i Gjeoshkencave të pajiset me licensë të plotë mbi përdorimin dhe aplikimin e programit NetCAD (Academic License Package) në kuadër të projekteve hulumtuese në Kosovë.



## UIBM PJESË E “PANAIRIT PANAIRIT TË PUNËS, KARRIERËS DHE NDËRMARRËSISË 2022”

30/11/2022

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është përfaqësuar në “Panairin e Punës, Karrierës dhe Ndërmarrësisë 2022”, që është mbajtur të mërkurën në sallën 1 Tetori në Prishtinë. Qendra për Zhvillim në Karrierë mbështetur edhe nga studentët kanë prezantuar mundësitë që ofron UIBM për të rinjtë që duan të zgjedhin një program studimi atraktiv për tregun e punës.

Zyrtari i Lartë i QZHK-së, Alban Fazliu, falënderoi organizatorët, në radhë të parë GIZ-in për ftesën dhe mundësitë që po ju ofron universiteteve për promovimin e tyre. Ndërsa, kryetarja e Këshillit Studentor të FTU-së, Fjolla Haziri, panairin e vlerësoi si rast shumë të mirë për studentët që të komunikojnë me biznese dhe organizata të ndryshme për mundësinë e punësimit dhe punës praktike.



## VIZITË STUDIMORE NË UNIVERSITETIN SAPIENZA TË ROMËS

02/12/2022

Në kuadër të projektit ResearchCULT, ERASMUS+, financuar nga Bashkimi Evropian, u realizu një vizitë dy ditore në Universitetin Sapienza të Romës, Itali. Pjesëmarrës në këtë vizitë studimore ishin përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë vendor dhe ndërkombëtar, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nga Kosova, duke përfshirë edhe Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), si institucion partner i përfaqësuar nga koordinatori lokal i projektit si dhe dekani i Fakultetit të Edukimit, prof. assoc. dr. Besim Gollopi dhe prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, prof. dr. Behxhet Shala.

Kjo është vizita e dytë studimore në kuadër të projektit “Përmirësimi i Kulturës Hulumtuese në Arsimin e Lartë në Kosovë”, Erasmus+, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i koordinuar nga Kolegji IBC-M, i organizuar në Universitetin Sapienza të Romës.



## PËRMBYLLET KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE: “MBINGARKESA KURRIKULARE – NDIKIMI NË ARRITSHMËRINË DHE MIRËQENIEN E NXËNËSVE DHE MËSIMDHËNËSVE”

02/12/2022

Ka përmbyllur punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Mbingarkesa kurrikulare – ndikimi në arritshmërinë dhe mirëqenien e nxënësve dhe mësimitdhënësve” që është mbajtur për dy ditë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Dita e dytë ka filluar me një përmbledhje dhe konkluzione nga punimet e ditës së parë.

Ndërsa, në vazhdim janë prezantuar kumtesat nga profesorët e Fakultetit të Edukimit në UIBM dhe fakulteteve tjera të edukimit që përgatisin mësimitdhënësit e rinj si dhe hulumtues nga Instituti Pedagogjik i Kosovës. Për dy ditë janë prezantuar gjithsej 21 kumtesa, 3 prej tyre nga vendet e rajonit.

Konferenca është organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe UIBM, ndërsa në hapje kanë marrë pjesë edhe drejtori i IPK, Nexhat Çoçaj dhe rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj. Drejtuesit e IPK -së kanë bërë të ditur se planifikohet që punimet e prezantuara gjatë konferencës të përmbledhen dhe botohen në një libër të veçantë.





## PUNËTORI DYDITORE NË KUADËR TË PËRGATITJEVE PËR RIAKREDITIM INSTITUCIONAL

10/12/2022

Në kuadër të përgatitjeve për procesin e riakreditimit institucional të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), më 9 dhe 10 dhjetor është mbajtur një punëtori e mbështetur nga “Heras Plus”. Pjesë e punëtorisë përveç rektorit, prof.dr. Alush Musaj dhe prorektorëve, kanë qenë edhe anëtarë të Këshillit Drejtues, dekanë, drejtorë dhe zyrtarë të administratës si dhe përfaqësues të studentëve dhe Alumnit. Rektori Musaj, në hapje të punëtorisë ka falënderuar “Heras Plus” për mbështetjen e vazhdueshme për UIBM. Ai gjithashtu ka vlerësuar punën dhe angazhimin e të gjitha strukturave të Universitetit sa i përket procesit të riakreditimit insitucional.



## 51 STUDENTË TË UIBM PËRFITOJNË BURSËN ELITARE DHE 2 BURSËN STEM NGA MASHTI

13/12/2022

Studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, falë rezultateve të arritura në procesin mësimor janë duke arritur të përfitojnë bursa edhe nga institucionet tjera, sikur Komuna e Mitrovicës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Për vitin akademik 2022/23 janë 51 studentë të UIBM që kanë përfituar bursën elitare në vlerë prej 700 eurosh nga MASHTI si dhe 2 të tjerë kanë përfitues bursën STEM.

Rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, ka përgëzuar përfituesit dhe ju ka uruar sukses atyre në rrugën e dijes. “Sukseset dhe rezultatet tuaja janë dëshmi e punës së mirë që bëhet në UIBM”, tha ai.



PREZANTOHEN REKOMANDIMET KRYESORE TE NXJERRURA NGA RAPORTET E VLERËSIMEVE TË  
VITIT 2022

15/12/2022

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, është mbajtur takimi në mes të menaxhmentit të UIBM-së, Përfaqësuesit nga Këshilli Drejtues, Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Parlamentit të Studentëve për Raportet e Vlerësimeve. Rektori, prof.dr. Alush Musaj, tregoi gatishmërinë e menaxhmentit për të përfshirë sa më shumë akterë në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit.

Shpat Musliu, nga Zyra për Sigurim të Cilësisë, prezantoi një përmbledhje të rekomandimeve nga raportet e vlerësimit, që disa prej tyre tashmë veç janë implementuar nga menaxhmenti, ndersa disa të tjera janë në proces të implementimit. Përfaqësuesit e Parlamentit Studentorë dakorduan të zhvillojnë takime me dekanët e fakulteteve rreth rezultateve të vlerësimit të studentëve, për personelin akademik.



## NË KAMPUSIN UNIVERSITAR U ZBULUA SKULPTURA “POSHTË – LARTË”

27/12/2022

Në një ceremoni të organizuar në kampusin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u zbulua të martën skulptura “Poshtë – Lartë”, e autorit, Butrint Morina. Skulptura e cila është zgjedhur fituese në kuadër të projektit “Vizionimi i hapësirave industriale të Mitrovicës”, mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, u zbulua nga rektori, prof.dr. Alush Musaj, drejtori i “7 Arte”, Lulzim Hoti, autori, Butrint Morina si dhe kryetarja e Parlamentit Studentor, Ariona Rushiti.





# UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

 028 515 516

 [info@umib.net](mailto:info@umib.net)

 [WWW.UMIB.NET](http://WWW.UMIB.NET)

 [uibm02](https://www.facebook.com/uibm02)

 [uibm\\_net](https://www.instagram.com/uibm_net)

 [Universiteti "Isa Boletini"-Mitrovicë](https://www.linkedin.com/company/universiteti-is-boletini-mitrovicë)

Zyra për Informim dhe Komunikim me  
Publikun-UIBM